



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 2234/10 Prot.

Tiranë, më 13.06.2024

VENDIM

Nr. 11, datë 13.06.2024

PËR

**“CAKTIMIN PËRKOHËSISHT TË Z. GRISELT MARKU, PËR TË
USHTRUAR DETYRËN E “NËPUNËSIT CIVIL GJYQËSOR”, NË
POZICIONIN E PUNËS “SPECIALIST I SHËRBIMEVE GJYQËSORE”
PRANË GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR
KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR”**

Këshilli i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i përbërë nga: **Erjon Bani Kryetar, Erjon Çela Anëtar dhe Saimir Shyti Anëtar**, në mbledhjen e tij të datës 13.06.2024, me propozim të Zëvendëskryetarit të Gjykatës,

KONSTATON SE:

I. FAKTI.

1. Me vendimin Nr. 6, datë 07.07.2023 Këshilli i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vendosi: *“1. Miratimin e Strukturës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas Aneksit nr.1 bashkëlidhur Vendimit. 2. Miratimin e organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas Aneksit nr.2 bashkëlidhur Vendimit. Ky vendim hyn në fuqi në datën 10.07.2023 dhe një kopje i dërgohet Këshillit të Lartë Gjyqësor.”*. Bashkëlidhur këtij vendimi gjendet struktura organike 2023, ku është përcaktuar dhe kategoria e pagave për secilin punonjës.

1.1. Sipas organikës së gjykatës janë katër *“Nëpunës gjyqësor”* me arsim të larë juridik, të cilët paguhen me klasën e pagës III, Lidhja 2, Kreu II/1 i VKM-së Nr. 326, datë 31.05.2023 për punonjësit mbështetës, duke u kualifikuar si *“ftues”*, të institucioneve në nivel rajonal/vendor. Pra, nëpunësit gjyqësor trajtohen si punonjës mbështetës marrëdhënia e të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës, për rrjedhojë nuk kanë statusin e nëpunësit civil gjyqësor.

2. Me shkresat Nr. 2004 Prot., datë 23.05.2024, nëpunësi gjyqësor z. Griselt Marku, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka kërkuar nga Këshilli i Gjykatës dhënien e statusit të nëpunësit civil

gjqësor, duke pretenduar se i plotëson të gjitha kushtet sipas kuadrit ligjor për ta fituar këtë status.

3. Ndodhur në këto kushte, Këshilli i Gjykatës administroi dosjen personale të z. Griselt Marku. Kështu, nga aktet e administruara rezulton se, **z. Griselt Marku** ka filluar marrëdhëniet financiare me Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në datën 04.05.2021 me anë të Urdhrit të Kancelarit me nr. 80, datë 30.04.2021 *“Për emërimin në kohë prove të një Nëpunësi Gjyqësor pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*. Kontrata e Punës me afat 3 muaj është lidhur po në datën 04.05.2021. Z. Griselt Marku në momentin e rekrutimit ka pasur arsim të lartë *“Bachelor në Juridik”* dhe *“Master i Shkencave”*.

3.1. Për këtë pozicion punë në datën 08.03.2021 është bërë shpallja e vendit vakant në adresën zyrtare të gjykatës. Njoftimi për vendin vakant për këtë pozicion punës është shpallur në datën 06.07.2020. Sipas këtij njoftimi kërkesa të përgjithshme, kandidati duhet të plotësoj të gjitha kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas nenit nr. 55, të Ligjit nr. 98/2016 datë 06.10.2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*. Po ashtu, në këtë njoftim theksohet se, **“Nëpunësi Gjyqësor është subjekt procedural dhe përmbush detyrat procedurale në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.”** Pra, kërkesë e posaçme për vendin e punës ndër të tjera është *“të jenë diplomuar në drejtësi”*. Në këtë procedurë konkurrimi e zhvilluar në dy faza sipas Ligjit *“Për nëpunësin civil”* kanë marrë pjesë tre kandidatë ku në përfundim u shpall fitues z. Griselt Marku.

4. Gjithashtu, përpara se Këshilli i Gjykatës të shprehej lidhur me kërkesën e bërë nga z. Griselt Marku për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, më datë 03.06.2024 nga kancelari i gjykatës i është dërguar z. Griselt Markut email me këtë përmbajtje: [...]

Ju keni paraqitur kërkesën tuaj me nr. 2004 prot, datë 23.05.2024, pranë Këshillit të Gjykatës, për dhënie statusi të nëpunësit civil gjyqësor.

Bazuar në nenin 86, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 6 dhe vijues të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar, nenin 40 të Vendimit nr.622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, ju njoftojmë se në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, verifikimit të pasurisë dhe figurës, ju duhet të plotësoni dhe dorëzoni personalisht, brenda datës 07.06.2024, formularët për veten dhe të afërmit tuaj, si më poshtë vijojnë:

- *Formularët shtesë A, B2 dhe B3, për kushtet e sigurisë për nëpunësit civilë gjyqësorë, sipas ligjit nr. 95/2016, të plotësohen dhe dorëzohen pranë zyrës së protokollit të GJKKO-së, jo më vonë se 5 ditë nga marrja, në rrugë elektronike e formularit.*
- *Çertifikatë të gjendjes familjare.*

Bashkëlidhur dërgohen formularët e sipërcituar [...]

5. Në përgjigje të email-it të mësipërm, z. Griselt Marku depozitoi pranë zyrës së protokollit formularët shtesë A, B2 dhe B3, për kushtet e sigurisë për nëpunësit civilë

gjqësorë, sipas Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i ndryshuar.

6. Mbështetur në faktet e mësipërme, Këshilli i Gjykatës çmon të marrë në analizë kërkesën e z. Griselt Marku dhe t’i ballafaqoj pretendimet e tij me kuadrin ligjor ndër vite dhe me atë që është në fuqi.

II. ARSYETIMI JURIDIK.

1. Lidhur me kërkesën për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor.

7. Në lidhje me interpretimin e normave juridike në përgjithësi, Këshilli i Gjykatës çmon se nuk ekzistojnë ligje apo dispozita që zgjidhin çështjet mbi interpretimin e normave ligjore, siç kanë qenë “Dispozitat mbi interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përgjithësisht”, të miratuar në pjesën paraprake të Kodit të Civil të Mbretit Zog të vitit 1929.¹ Megjithatë, me qëllim zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, Gjykatat duhet të nisen nga kritere logjike-juridike mbi interpretimin e normave, siç janë: interpretimi tekstual, apo literal i dispozitës ligjore, më tej nëse ky kriter nuk do të mjaftojë për kuptimin e domethënies së normës, Këshilli duhet të vijojë me interpretimin logjik, që nënkupton analizën e dispozitës mbi bazën e qëllimit praktik të saj (*ratio legis*); pra, në analizën që bazohet në kuptimin e normës, duke gjetur qëllimin që ajo ka ose duhet të ketë, në bazë të një krahasimi të dispozitës në raport me dispozitat e tjera në mënyrë sistematike, duke identifikuar nga sistemi juridik qëllimin e vërtetë të normës dhe rolin që ajo në rendin juridik (*interpretim teleologjik*). Gjithashtu, për të nxjerrë kuptimin e dispozitës, Këshilli duhet të bëjë dhe *interpretimin historike* të dispozitave, për të parë kontekstin në të cilën është nxjerrë norma, për të konkluduar më pas nëse norma në kushtet kur është nxjerrë i përgjigjet rrethanave aktuale dhe evolimit të legjislacionit dhe jurisprudencës. Kjo për faktin pasi ligji duhet të interpretohet nën dritën e kushteve aktuale (*interpretimi evolues*). Ndodhur në këto kushte, Këshilli i Gjykatës çmon të bëjë interpretimin e dispozitave që kanë rregulluar kompetencat, nivelin e pagës për pozicionet punës “Nëpunës gjyqësor” dhe “Specialist” i shërbimeve mbështetëse, duke përdorur të gjitha mënyrat e interpretimit të cituar më lartë.

8. Mbështetur në nenet 12, 14/a, 14/b e vijues të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 1 të ligjit nr. 7381, datë 8.5.1990 “Për krijimin e Ministrisë së Drejtësisë”, Ministri i Drejtësisë ka nxjerrë urdhrin Nr. 1830 datë 3.4.2001 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore”.² Në nenin 3 të kësaj rregullore, nën titullin “Struktura e administratës gjyqësore” parashikohet shprehimisht se: “Struktura e administratës gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit përbëhet nga: kancelari, sekretaria gjyqësore, sekretari i seancës, nëpunësi gjyqësor, sektori ose zyra

¹Në nenin 2 të të Kodit të Civil të Mbretit Zog të vitit 1929 parashikohej se: “N’aplikim, ligjave nuk munt t’u epet tjetër sens veç atij që del qartazi nga kuptimi veti i fjalëve tue u marrë parasysh lidhja e tyne, si dhe nga qëllimi i ligjëvuësit. Kur një kontestim nuk mund të zgjidhet me një dispozitë të çqueme të ligjës, merren parasysh dispozitat që rregullojnë raste shëmbëlllore ose çashtje analloge: kur me gjithë këtë rasti mbetet i errët, zgjidhja bahet simbas parimevet të përgjithëshme të së drejtës. Ndërsa sipas nenit 3, ishte parashikuar se: Ligjat që përmbajnë dispozita ndëshkimore dhe ato që përkufizojnë ushtrimin e lirë të së drejtave ose që formojnë përjashtime në rregullat e përgjithëshme ose në të tjera ligja, nuk shtrihen tej rasteve dhe kohënave që tregohen në to.”.

² Ky urdher së bashku me rregulloren është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 17, datë 27.04.2001.

e arkivit, sektori ose zyra për marrëdhëniet me publikun dhe median, sektori ose zyra e buxhetit, sektori ose zyra e administratës ndihmëse.”, ndërsa në nenin 4 të kësaj rregullore, nën titullin “**Objekti i veprimtarisë së administratës gjyqësore**” parashikohet shprehimisht se: “**Administrata gjyqësore e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, në përputhje me ligjin dhe këtë Rregullore, ushtron veprimtari procedurale dhe veprimtari administrative**.”. Gjithashtu, në nenin 22 të kësaj rregullore, nën titullin “**Nëpunësi gjyqësor**” parashikohet shprehimisht se: “**Nëpunësi gjyqësor në kryerjen e detyrave të tij bashkëpunon me sekretarin gjyqësor dhe sekretarin e seancës. Nëpunësi gjyqësor duhet të marrë pjesë në seancën gjyqësore dhe merr masa për zbatimin e urdhrave të gjykatës për njoftimin dhe futjen në sallë të dëshmitarëve, ekspertëve dhe kërkon nga ata solemnitet e respektim të trupit gjykues. Orienton palët të vendosen para gjykatës, paditësi në krahun e djathtë të trupit gjykues, i padituri në të majtë me pamje përballë gjykatës. Po kështu i pandehuri në të majtë dhe përfaqësuesi akuzës në të djathtë të trupit gjykues. Njofton aktet me shkrim, telefon e kundrejt firmës së marrësit, kur është e mundur, dëshmitarët, ekspertët etj., sipas mënyrës së përcaktuar në procedurën civile e penale, dhe, në çdo rast, tregon kujdes për eliminimin e shkaqeve të pavlefshmërisë së njoftimeve e të akteve. Aktet e njoftuara para datës së caktuar për seancën gjyqësore i dorëzohen te sekretari seancës përkatës.**”. Ndërkohë në nenin 26 të kësaj rregullore, nën titullin “**Administrata ndihmëse**” parashikohet shprehimisht se: “**Sektori apo zyra e administratës ndihmëse ushtron veprimtarinë e saj nën kujdesin e kancelarit të gjykatës dhe ka për detyrë që në përputhje me urdhërimet e kryetarit dhe kancelarit të gjykatës të mbështesë veprimtarinë e gjykatës dhe të administratës gjyqësore në përmbushjen e detyrave të tyre. Në përbërje të sektorit a zyrës së administratës ndihmëse janë punonjës të mirëmbajtjes, shoferë, pastrues-sanitarë, roje etj. Përcaktimi i hollësishëm i strukturës, përbërjes dhe numrit të punonjësve të administratës ndihmëse caktohet me miratimin e strukturës dhe organikës së çdo gjykate.**”. Nga interpretimi literal, logjik dhe sistematik i këtyre dispozitave rezulton se **nëpunësi gjyqësor** si pjesë e administratës gjyqësore **ushtron kryesisht veprimtari procedurale**³ por ushtron dhe veprimtari administrative.⁴

³ Në nenin 5 të kësaj rregullore nën titullin “**Fushat e veprimtarisë procedurale**” parashikohet shprehimisht: “**Administrata gjyqësore, ndjek dhe realizon përmbushjen e veprimtarisë procedurale si vijon: Pranimi, mbajtja dhe administrimi i akteve procedurale, provave materiale dhe shkresore të paraqitura. Organizimi i shortit për ndarjen e çështjeve, si dhe shpërndarja e çështjeve për gjykim sipas shortit. Njoftimet dhe komunikimet e akteve procedurale. Përgatitja dhe shpallja e listës së gjykimeve. Mbajtja e procesverbaleve të seancës gjyqësore, si dhe respektimi i kërkesave të solemnitetit në gjykim. Evidentimi i shpenzimeve gjyqësore. Ekzekutimi i vendimeve të lëna në kompetencë të gjykatës. Marrja në dorëzim pas zbardhjes e nënshkrimit të vendimeve përfundimtare. Kalimi për gjykim në gjykatat e shkallëve të tjera. Disponimi i provave materiale sipas vendimit të gjykatës. Depozitimi në arkiv i dosjeve që kanë marrë formë të prerë, si dhe publikimi i vendimeve. Krijimi i fashikujve gjyqësore. Krijimi, plotësimi dhe ruajtja e regjistrave të gjykatës. Krijimi i volumeve të vendimeve civile dhe penale. Krijimi i kushteve për të akuzuarit, palët dhe mbrojtësit e tyre, si dhe për të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në proces për realizimin e së drejtës së mbrojtjes dhe informimit. Funksionimi i teknikave kompiuterike për evidentimin e veprimeve procedurale dhe sigurimin e informacioneve e statistikave të nevojshme.**”.

⁴ Në nenin 6 të kësaj rregullore nën titullin “**Fushat e veprimtarisë administrative**” parashikohet shprehimisht: “**Administrata gjyqësore ndjek dhe realizon përmbushjen e veprimtarisë administrative në fushat si vijon: Pranimi, evidentimi dhe trajtimi i korrespondencave të ardhura nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike e fizike private, për çështje të karakterit administrativ. Mirëadministrimi i ambienteve dhe mjeteve të punës së gjykatës dhe shërbimet e mirëmbajtjes. Administrimi i arkivës së akteve procedurale dhe administrative, magazinës së mjeteve e pajisjeve dhe provave materiale. Administrimi i fondeve financiare të vëna në dispozicion dhe dokumentimi i veprimeve financiare, sipas dispozitave ligjore**

9. Për shkak të rolit dhe rëndësisë të shërbimeve mbështetëse në Gjykatën e Krimeve të Rënda, për të cilin kërkohej nivel tjetër kualifikimi dhe për rrjedhojë trajtim financiar i ndryshëm, u miratua **vendimi nr. 20, datë 14.01.2009 i Këshillit të Ministrave** “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të administratës gjyqësore, të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit”. Në këtë vendim parashikohet shprehimisht se: “1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihet administrata gjyqësore e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. 2. **Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve të administratës gjyqësore, në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit, në pozicionet “Specialist”, “Sekretar gjyqësor”, “Kryetar dege”, “Kryesekretar gjyqësor” dhe “Përgjegjës i shërbimeve mbështetëse në Gjykatën e Krimeve të Rënda”, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.** 3. Paga e grupit, (kolona 1), diplomë e shkollës së lartë, është 11 000 lekë në muaj. 4. Shtesa për vjetërsi në punë, (kolona 2), jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, por jo më shumë se për 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit. 5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1 të këtij vendim.”.

10. Për të bërë dallimin midis punonjësve të administratës gjyqësore me arsim të lartë, kur vendi i punës e kërkon, me punonjësit e tjerë mbështetës që nuk e kanë këtë arsim, u miratua **vendimi nr. 607, datë 11.06.2009 i Këshillit të Ministrave** “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë të administratës gjyqësore, të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, si dhe punonjësve me arsim të lartë të administratës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit”. Në këtë vendim parashikohet shprehimisht se: “1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen punonjësit me arsim të lartë të administratës gjyqësore, në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, si dhe punonjësit e administratës së prokurorive, pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit. 2. **Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve me arsim të lartë të administratës gjyqësore, në pozicionin nga “Specialist” deri në “Përgjegjës i shërbimeve mbështetëse”, në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit, si dhe të punonjësve me arsim të lartë të administratës së prokurorive, në pozicionet nga “Specialist” deri në “Kryetar dege”, pranë këtyre gjykatave, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.....8. Punonjësit, që nuk përmbushin kriterin e arsimit të lartë, kur vendi i punës e kërkon, do të trajtohen në pagë në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore12. Vendimi nr.20, datë 14.1.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të administratës gjyqësore, të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit”, si dhe dispozitat e tjera, që bien në kundërshtim me këtë vendim, **shfuqizohen**. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009”.⁵ Nga interpretimi literal, logjik dhe sistematik i këtyre dispozitave rezulton se nëpërmjet këtij vendimi është dashur të bëhet dallimi midis punonjësve me arsim të lartë kur vendi i punës e kërkon, të cilët trajtohen në pagë me strukturën e pagave**

në fuqi. Përgatitja e materialeve dhe kushteve të nevojshme për veprimtaritë me karakter administrativ, profesional e kulturor. Realizimi i marrëdhënieve me publikun dhe median.”.

⁵ Ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 96, datë 30.06.2009.

të nëpunësve të shërbimit civil dhe punonjësve të tjerë mbështetës që nuk e kanë këtë arsim. Ndryshe nga VKM-ja Nr. 20, datë 14.01.2009, e cila duket sikur është krijuar vetëm për disa pozicione pune nominative, VKM-ja Nr. 607, datë 11.06.2009 përfshin në fushën e veprimtimit të saj të gjithë punonjësit me arsim të lartë nga niveli ekzekutiv “specialist” deri në nivelin e ulët drejtues “Përgjegjës sektori”. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj VKM-je është dashur të theksohet se kriteri bazë ndarës midis dy kategorive të punonjësve në gjykatës është “arsimi i lartë ku vendi i punës e kërkon”.

10.1. Gjithashtu, për të rregulluar klasifikimin e pagave për punonjës mbështetës është miratuar vendimi Nr. 717, datë 23.6.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”. Në këtë vendim parashikohet shprehimisht se: “1. **Klasat dhe nivelet e pagave për klasë të punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore qendrore, të cilët nuk trajtohen në pagë me strukturën e pagave të nëpunësve të shërbimit civil, janë sipas lidhjes nr. I** “Nivelet e pagës bazë për klasë në administratën e Presidentit, Kuvendit, në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrave të linjës, institucione qendrore, në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, **me 10 klasa.** 2. Klasat dhe nivelet e pagave për klasë të punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore, rajonale e vendore, si dhe të institucioneve qendrore, të grupit të tretë, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, caktohen sipas lidhjes nr. II “Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet rajonale e vendore”, me 14 klasa. 3. Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për punonjësit mbështetës, në institucionet buxhetore, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjes I/I “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë, për punonjësit mbështetës në administratën e ministrave të linjës, institucioneve të pavarura, institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij. 4. **Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për punonjësit mbështetës në institucionet buxhetore, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjeve përkatëse, si nën lidhje të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.** 5. Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për punonjësit mbështetës në institucionet buxhetore, të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjes II/I “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në administratën e institucioneve rajonale dhe vendore, si dhe të institucioneve qendrore, të grupit të tretë, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. 6. Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për punonjësit mbështetës në institucionet buxhetore, të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjeve përkatëse, si nën lidhje të lidhjes nr. II, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”⁶ Nga përmbajtja e këtij vendimi nuk rezulton që të përmendet si pozicion pune “nëpunës gjyqësor”.

11. Gjithashtu, roli i administratës gjyqësore në përgjithësi dhe pozicioni i punës “Nëpunës gjyqësor” në veçanti është trajtuar dhe nga jurisprudenca kushtetuese. Kështu, në vendimin Nr. 20, datë 09.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera thuhet se: “14.Gjykata, duke pasur parasysh frymën dhe përmbajtjen e neneve 7, 42, 144 dhe

⁶ Gjithashtu, edhe në vendimet Nr. 234, datë 20.4.2022 dhe Nr. 326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” nuk rezulton që të përmendet si pozicion pune “nëpunës gjyqësor”. Kjo për faktin pasi nuk hynë në kategorinë e pozicioneve të punës me natyrë mbështetëse dhe për të cilin kërkohet jo arsim i lartë.

145 të Kushtetutës çmon se roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 03.05.2007).....17. Në bazë të ligjit nr. 9877 objekt shqyrtimi, shërbimet ndihmëse në gjykatë kryhen nga sekretaria gjyqësore, degët dhe sektorët e administratës, të ekonomisë, financës, informatizimit, regjistrimit dhe ruajtjes së dokumenteve (neni 39). **Disa nga këto shërbime të administratës gjyqësore kryejnë edhe veprimtari të natyrës procedurale penale, civile ose administrative, të cilat janë pjesë e pandarë e një procesi të rregullt ligjor.** Sekretari i gjykatës kryen funksione të rëndësishme të sqaruara në Kodin e Procedurës Penale (KPP) dhe Kodin e Procedurës Civile (KPC). Kështu, sipas kreut II të KPP mbi “Njoftimet”, sekretaria ruan sendet e sekuestruara (neni 214), apo mban procesverbalet e seancës, sipas parashikimeve të nenit 345 të KPP. Sipas KPC, roli dhe detyrat e sekretarit gjyqësor (neni 77) janë dokumentimi për të gjitha efektet e veprimtarive të mirëfillta të gjykatës, të palëve e pjesëmarrësve në proces. Sekretari merr pjesë në të gjitha veprimet e gjykatës për të cilat duhet të mbahet procesverbal. Ai lëshon kopje dhe ekstrakte autentike të dokumenteve të përpiluara, regjistron çështjet në dorë, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit, dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor. **Edhe nëpunësi gjyqësor merr pjesë në seancë gjyqësore dhe merr masa për zbatimin e urdhrave, ndjek procedurën e njoftimit të akteve dhe kryen detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor** (neni 78). **Sic rezulton nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme, shërbimet ndihmëse në gjykatë luajnë një rol të rëndësishëm mbështetës për gjykatën dhe gjyqtarin në dhënien e drejtësisë.** Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se funksionet e sekretariatit të gjykatës dhe ajo e nëpunësit gjyqësor luajnë një rol të rëndësishëm mbështetës për gjykatën dhe gjyqtarin në dhënien e drejtësisë. Sipas këtij vendimi nëpunësit gjyqësor kryejnë veprimtari të natyrës procedurale.

12. Gjithashtu, për të përcaktuar nëse “Nëpunësit gjyqësor” i plotësojnë kushtet ligjore për t’u konsideruar nëpunës civil gjyqësor, Këshilli i Gjykatës, në kuadër të interpretimit historik çmon t’i referohet Ligjit Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”⁷. Kështu, në nenin 3 të këtij Ligji nën titullin “Përkufizime” parashikohet shprehimisht se: “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. “Administratë gjyqësore” është tërësia e nëpunësve që ushtrojnë funksione publike me natyrë procedurale apo administrative, si dhe funksione të shërbimeve mbështetëse në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. 2. “Nëpunës civil gjyqësor” janë nëpunësit që ushtrojnë funksione publike me natyrë procedurale apo administrative, si dhe funksione të shërbimeve mbështetëse në administratën gjyqësore. 3. “Zyrë administrative” është pjesa e strukturës së administratës gjyqësore, që merret me organizimin dhe menaxhimin e veprimtarive administrative në mbështetje të gjykatave dhe gjyqtarëve. 4. “Shërbim civil gjyqësor” është tërësia e rregullave të njëtrajtshme për organizimin e nëpunësve civilë që ofrojnë shërbimet e tyre në administratën gjyqësore me qëllim krijimin e një shërbimi civil profesional, të qëndrueshëm dhe efikas. 5. “Veprimtari administrative” është veprimtaria e administratës gjyqësore që

⁷ Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 55, datë 17.4.2013.

kryhet nga zyra administrative për organizimin dhe menaxhimin, në mbështetje të gjykatave dhe gjyqtarëve, ku përfshihen edhe shërbimet ndihmëse të mirëmbajtjes, transportit, pastrimit apo sigurisë. 6. “Veprimtari gjyqësore” është veprimtaria që kryejnë gjykatat dhe gjyqtarët në ushtrimin e veprimtarive që Kushtetuta dhe ligji u ngarkon atyre për dhënien e drejtësisë. 7. “Veprimtari procedurale” është veprimtaria që kryen zyra e gjykatës, sipas legjislacionit procedural gjyqësor në fuqi, në çështje civile, penale ose çështje të tjera që shqyrtohen nga gjykata. 8. “Zyrë e gjykatës” është pjesa e strukturës së administratës gjyqësore, që mbështet dhe ndihmon veprimtarinë gjyqësore të gjykatës dhe gjyqtarëve nëpërmjet veprimtarive procedurale. Zyra e gjykatës përbëhet nga kryesekretari gjyqësor, sekretarët gjyqësorë dhe nëpunësit gjyqësorë.”, ndërsa në nenin 4 të këtij Ligji nën titullin “Parime të përgjithshme” parashikohet shprehimisht se: “Administrata gjyqësore është e krijuar dhe funksionon në bazë të parimeve të profesionalizmit, paanshmërisë, integritetit, transparencës, qëndrueshmërisë, shërbimit për publikun, meritës dhe vazhdimësisë në karrierë, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.”.

12.1. Gjithashtu, në nenin 21 të Ligjit Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, nën titullin “Veprimtaria e zyrës së gjykatës”, parashikohet shprehimisht se: “1. Zyra e gjykatës kryen veprimtarinë procedurale, si edhe detyra të tjera me natyrë administrative në funksion të saj, të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. 2. Çdo zyrë gjykate përbëhet nga kryesekretari gjyqësor, sekretarët gjyqësorë dhe nëpunësit gjyqësorë, që i kryejnë detyrat e tyre nën drejtimin e kancelarit të gjykatës, duke respektuar rreptësisht vendimet dhe urdhrat e nxjerra nga gjyqtarët brenda kompetencave të tyre gjyqësore.”, ndërsa në nenin 25 të këtij Ligji nën titullin “Nëpunësi gjyqësor”, parashikohet shprehimisht se: “1. Nëpunësi gjyqësor kryen detyra procedurale dhe detyra të tjera me natyrë administrative, të përcaktuara në legjislacionin procedural gjyqësor në fuqi, ose që i ngarkohen atij nga kancelari, sipas parimeve të ligjshmërisë, paanshmërisë, si edhe të unitetit të veprimit e të varësisë hierarkike. 2. Ai bashkëpunon me kryesekretarin gjyqësor dhe sekretarin gjyqësor për kryerjen e detyrave, nën drejtimin e kancelarit.”. Gjithashtu, në nenin 26 të këtij Ligji nën titullin “Kompetencat e nëpunësit gjyqësor” parashikohet shprehimisht se: “Nëpunësi gjyqësor ushtron edhe detyrat e mëposhtme: a) merr pjesë në seanca gjyqësore dhe merr masa për zbatimin e urdhrave të gjykatës për njoftimin e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në proces; b) nxjerr aktet e komunikimit që kanë të bëjnë me njoftimin apo thirrjen, me shkrim, telefon apo mjete të tjera teknike, kur është e mundur dhe sipas mënyrës së përcaktuar në procedurat civile dhe penale, duke u kujdesur për të shmangur çdo arsye pavlefshmërie të njoftimit të akteve. Ai i dorëzon sekretarit gjyqësor përkatës aktet e njoftimit përpara datës së përcaktuar për seancën gjyqësore; c) siguron kushtet e sallës së gjykimit që do të përdoret, si edhe rregullin brenda saj; ç) verifikon që mjetet e nevojshme për gjykim të jenë në kushte të mira për përdorim, duke kërkuar, nëse është e nevojshme, praninë e shërbimeve teknike, me qëllim që të lejohet funksionimi i duhur i pajisjeve, duke njoftuar sekretarin gjyqësor nëse identifikohet ndonjë e metë; d) bashkëpunon me sekretarët gjyqësorë për zhvillimin e proceseve, për përgatitjen e dokumenteve, vërtetimeve, njoftimeve dhe akteve të tjera të kërkuara prej tyre, si edhe, kur nevojitet, përgatit kopje të dokumenteve dhe bashkëlidhje të dosjeve; dh) bashkëpunon me sekretarët gjyqësorë për regjistrimin dhe klasifikimin e akteve që dërgohen dhe merren nëpërmjet shërbimit

postar.”. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave arrihet në përfundimin se: **i)** nëpunësi gjyqësor kryen detyra procedurale dhe detyra të tjera me natyrë administrative, të përcaktuara në legjislacionin procedural gjyqësor në fuqi duke respektuar rreptësishtë vendimet dhe urdhrat e nxjerra nga gjyqtarët brenda kompetencave të tyre gjyqësore; **ii)** nëpunësi gjyqësor është pjesë e shërbimeve gjyqësore, pra pjesë e zyrës së gjykatës dhe gjatë ushtrimit të detyrës ai bashkëpunon me kryesekretarin gjyqësor dhe sekretarin gjyqësor. Pra, nëpunësi gjyqësor nuk ka qenë asnjëherë pjesë e shërbimeve mbështetëse si strukture apo pjesë e zyrës administrative;⁸ **iii)** aktualisht në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nëpunësi gjyqësor kryen të njëjtat funksione sikurse parashikohet në këtë ligj.

12.2. Gjithashtu, në Ligjin Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” rregullohet statusi i nëpunësve civilë të shërbimit civil gjyqësor dhe statusi i personelit të shërbimeve mbështetëse, si dhe kërkesat e veçanta për rekrutim në shërbimin civil gjyqësor. Kështu, në nenin 38 të këtij Ligji nën titullin “**Nëpunësit civilë të shërbimit civil gjyqësor**” parashikohet se: “**1. Shërbimi civil gjyqësor përbëhet nga kryesekretari gjyqësor, sekretarët gjyqësorë, nëpunësit gjyqësorë dhe nëpunësit e tjerë që ushtrojnë veprimtari administrative në zyrën administrative. 2. Karriera e nëpunësve civilë gjyqësorë në administratën gjyqësore fillon bazuar në aktin e ligjshëm të emërimit dhe zhvillohet sipas një marrëdhënieje të qëndrueshme punësimi, të bazuar në shpërblimin, në përputhje me nivelin e përmbushjes së shërbimeve.**”, ndërsa në nenin 39 të këtij Ligji nën titullin “**Statusi i nëpunësve civilë të shërbimit civil gjyqësor**” parashikohet se: “**1. Statusi i nëpunësve civilë të shërbimit civil gjyqësor rregullohet nga dispozitat e parashikuara në ligjin për statusin e nëpunësit civil.**”. Gjithashtu, në nenin 40 të këtij Ligji nën titullin “**Statusi i personelit të shërbimeve mbështetëse**” parashikohet se: “**1. Nëse nuk ka kategori të nëpunësve gjyqësorë civilë, që kanë kualifikim të posaçëm apo teknik të kërkuar për kryerjen e veprimtarive specifike në gjykatë, që lidhen me shërbimet mbështetëse, punësohet punonjës me kontratë pune në administratën gjyqësore. 2. Punonjësit me kontratë nuk ushtrojnë funksione publike, por ofrojnë shërbime në administratën gjyqësore në fushën e shërbimeve mbështetëse, sic janë mirëmbajtja, shërbimi, transporti apo ruajtja. 3. Punonjësi me kontratë emërohet dhe shkarkohet nga kancelari. 4. Punonjësi me kontratë ka statusin dhe gëzon të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në Kodin e Punës.**”, ndërsa në nenin 42 të këtij Ligji nën titullin “**Kërkesa të veçanta për rekrutim në shërbimin civil gjyqësor**” parashikohet shprehimisht se: “**1. Kërkesat e përgjithshme për t’u kualifikuar për rekrutim në shërbimin civil gjyqësor janë të njëjta me ato që parashikohen në legjislacionin për shërbimin civil. 2. Kërkesat ligjore, në lidhje me arsimin, janë si më**

⁸ Në nenin 14 të Ligjit Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, nën titullin “**Struktura e zyrës administrative**”, parashikohet shprehimisht se: “**1. Në çdo gjykatë të shkallës së parë dhe në çdo gjykatë apeli krijohet zyra administrative, e cila funksionon në bazë të parimeve të hierarkisë, ndarjes së funksioneve dhe bashkërendimit të punës. Sipas nevojave, në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit që ndodhen në të njëjtin rreth gjyqësor krijohet vetëm një zyrë administrative, si pjesë përbërëse e administratës gjyqësore të gjykatës me numrin më të madh të punonjësve. 2. Zyra administrative përbëhet nga nëpunësit civilë gjyqësorë dhe personeli i shërbimeve mbështetëse. Përshkrimet e tyre të punës hartohen dhe miratohen sipas manualit të përshkrimit të punës të çdo gjykate. 3. Sipas nevojave, brenda zyrës administrative, krijohen sektorët e mëposhtëm: a) sektori përgjegjës për financat me varësi të drejtpërdrejtë nga kryetari i gjykatës; b) sektori i marrëdhënieve me publikun dhe median; c) sektori i arkivit; ç) sektori i teknologjisë së informacionit; d) sektori i shërbimeve mbështetëse; dh) çdo sektor tjetër, që vlerësohet i nevojshëm për përmbushjen e veprimtarive të zyrës administrative.**”.

poshtë: a) sekretarët gjyqësorë të kenë diplomë të nivelit të parë të arsimit të lartë, me preferencë në profilin juridik; b) nëpunësit gjyqësorë të kenë diplomë të nivelit të parë të arsimit të lartë; c) nëpunësit në zyrën administrative të kenë diplomë të nivelit të parë të arsimit të lartë. 3. Kryesekretari gjyqësor emërohet nga radhët e sekretarëve gjyqësorë, sipas rregullave për emërimin e nëpunësve gjyqësorë civilë.”. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se, nëpunësin gjyqësor vetë ligjvënësi e ka kualifikuar pjesë të shërbimit civil gjyqësorë. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur ligjvënësi edhe për punonjësit e shërbimit mbështetës, të cilët si pjesë e zyrës administrative të gjykatës i konsideron nëpunës civil gjyqësorë nëse kanë kualifikim të posaçëm për kryerjen e veprimtarive specifike në gjykatë, pra nëse kanë diplomë të nivelit të parë të arsimit të lartë.

12.2.1. Gjithashtu, në Ligjin Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se, statusi i nëpunësve civilë të shërbimit civil gjyqësor rregullohet nga dispozitat e parashikuara në ligjin për statusin e nëpunësit civil. Për rrjedhojë ashtu sikurse nëpunësit civilë në përgjithësi edhe nëpunësit civil të shërbimeve gjyqësore funksionojnë në bazë të parimeve të profesionalizmit, paanshmërisë, integritetit, transparencës, qëndrueshmërisë, shërbimit për publikun, meritës dhe vazhdimësisë në karrierë, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.⁹ Këshilli i Gjykatës çmon të theksoj se Ligji Nr. 8549 “Statusi i nëpunësit civil”, ka dalë në zbatim të drejtpërdrejt të nenit 107 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht: “1. *Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit.* 2. *Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.* 3. *Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohen me ligj.*”¹⁰ Pra, qëllimi i ligjvënësit nëpërmjet këtij ligji, ka qenë të rrisë garancitë për punonjësit e administratës publike. Kjo për faktin, pasi **në rastin e punëmarrësve të administratës publike, nuk kemi të bëjmë thjesht me një “kontratë” pune, por me një marrëdhënie pune të lidhur me përmbushje të shërbimeve publike, për normalitetin dhe përmbushjen e të cilave nuk kanë interes vetëm funksionari punëdhënës dhe punëmarrësi por ka një interes publik.** Punësimi, ecuria e punësimit dhe disiplina në përmbushjen e shërbimit publik, nëse ushtrohen në mënyrë abuzive e në shkelje të ligjit, nuk dëmtojnë e cenojnë thjesht nëpunësin e punonjësin punëdhënës e punëmarrës, por dëmtojnë interesin publik në tërësi. **Interesi publik kërkon që punonjësit e administratës shtetërore të përzgjidhen sipas meritës e aftësive, që këta punonjës të jenë të disiplinuar e korrektë në përmbushjen e punës dhe detyrës, të trajtohen me dinjitet në çdo pikëpamje, të jenë të përgjegjshëm e njëkohësisht të garantuar për punën e shërbimin që bëjnë (kjo jo për interes të tyre por të publikut në tërësi), të kenë qëndrueshmëri dhe mbrojtje nga abuzimi i eprorëve, etj.**¹¹

12.3. Gjithashtu, në Ligjin Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” është rregulluar statusi i punonjësve të administratës gjyqësore që kanë qenë në punë ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kështu, në nenin 55 të këtij Ligji nën titullin “**Dispozita kalimtare**” parashikohet shprehimisht se: “1. **Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit gjyqësor civil, të përcaktuara**

⁹ Shiko nenin 4 të Ligjit Nr. 109/2013.

¹⁰ Vendimi Nr. 1, datë 17 Janar 2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹¹ Vendimi Nr. 7, datë 1 Qershor 2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

në këtë ligj, dhe që janë emëruar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për statusin e nëpunësve civilë, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 3 vjet, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë gjyqësorë. 2. Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit gjyqësor civil dhe që nuk plotësojnë kushtet e emërimit, sipas këtij ligji, apo kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, janë nëpunës civilë gjyqësorë në periudhë prove. Periudha e provës është 2 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”. Nga interpretimi logjik dhe sistematik i dispozitave të këtij ligji arrihet në përfundimin se: **1)** Nëpunësit ekzistues në gjykatat e shkallës së parë, apelit dhe në Gjykatën e Lartë, përfshi këtu nëpunësin gjyqësor dhe punonjësit me arsim të lartë në shërbimet mbështetëse, të cilët si pjesë e zyrës administrative të gjykatës, **janë, për shkak të ligjit (ipso lege), nëpunës civilë gjyqësorë nëse: i)** Janë emëruar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për statusin e nëpunësve civilë; ose **ii)** Janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 3 vjet; **2)** Nëpunësit ekzistues në gjykatat e shkallës së parë, apelit dhe në Gjykatën e Lartë, përfshi këtu nëpunësit gjyqësor dhe punonjësit shërbimeve mbështetëse, të cilët janë pjesë e zyrës administrative të gjykatës janë nëpunës civilë gjyqësorë për një periudhë prove prej 2 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji nëse nuk plotësojnë kushtet e emërimit, sipas këtij ligji sikurse është arsimit i lartë. Është lënë një periudhë dy vjeçare për nëpunësit civil të shërbimeve gjyqësore. **Pra, nga përmbajtja e këtij ligji rezulton se nëpunësit gjyqësor dhe specialistët e shërbimeve mbështetëse me arsim të lartë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë e cila është shndërruar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë përkufizuar nga vetë legjislatori si pozicione pune që ushtrojnë funksione publike me natyrë procedurale apo administrative e për rrjedhojë janë nëpunës civil gjyqësor. Këta punonjës sikurse do të arsyetohet më poshtë që prej vitit 2001 e në vijim kanë ushtruar të njëjtat detyra dhe vazhdojnë ende t’i kryejnë.**

12.4. Ligji Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” është kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese nga Unioni i Gjujtarëve të Shqipërisë, duke pretenduar se nuk është miratuar me shumicë të cilësuar. Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 10 datë 06.03.2014 ka shfuqizuar këtë ligj pasi nuk është miratuar me shumicë të cilësuar, duke arsyetuar ndër të tjera se: [...]

26. Gjykata, vëren se klasifikimi i ligjit objekt shqyrtimi, si një ligj organik dhe pjesë komplementare e ligjit organik për pushtetin gjyqësor, nuk mbështetet vetëm në leximin e normës ligjore apo kuptimin semantik të nenit 43 të referuar më lart, por qartësohet edhe nga qëndrimet e mëparshme të mbajtura në jurisprudencën kushtetuese. Gjykata është shprehur edhe më parë se roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 03.05.2007).

27. E konsideruar nga ligjvënësi (ligji nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”) si pjesë integrale e organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor dhe e interpretuar në jurisprudencën kushtetuese si pjesë organizative dhe funksionale e këtij pushteti (shih vendimin e

Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 03.05.2007), Gjykata çmon se administrata gjyqësore gëzon të njëjtën mbrojtje procedurale kushtetuese, në kuadër të procedurës së miratimit të ligjeve me shumicë të cilësuar, njëlloj siç parashikohet për pushtetin gjyqësor.

28. Gjykata çmon të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë me analogji edhe procedurën e miratimit me shumicë të cilësuar të ligjeve të ngjashme me ligjin e kundërshtuar, për nga lënda që trajtojnë. **Ligji objekt shqyrtimi, ndjek konceptin dhe strukturën e ligjit për shërbimin civil, pavarësisht specifikave dhe natyrës atipike që paraqet administrata gjyqësore në raport me “nëpunësin civil”, që ushtron një funksion publik klasik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore. Funksionet që kryen administrata gjyqësore, veçanërisht në shërbimin ndaj publikut, përfshihen në kuptimin e funksionit publik, sipas përcaktimit që Kushtetuta jep në nenin 107 të saj. Në këtë kuptim, Gjykata konsideron orientues edhe historikun legjislativ për shërbimin civil, i cili dëshmon qartë se ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” si dhe ligji nr. 152/2013, në preambul referojnë si bazë kushtetuese të miratimit të tyre, nenin 81, paragrafi 2, shkronja “a”, të Kushtetutës, i cili parashikon vendimmarrjen parlamentare me shumicë të cilësuar. [...]**¹²

13. Më pas statusi i administratës gjyqësore u rregulluar me Ligjin Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Përpara së të vijohet me interpretimin e këtij ligji, Këshilli i Gjykatës çmon t’i referohet relacionit dhe raportin të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë që shoqëroi miratimin e Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku ndër të tjera arsyetohet se: “**3.3.12. Përcaktimi i rregullave të nëpunësve civilë gjyqësor. Risi e projektligjit është përfshirja e punonjësve të gjykatave në një status të ri të rregulluar tashmë nga ky projektligj për të ofruar garanci, qëndrueshmëri, karrierë, profesionalizëm, ngritje të kapaciteteve, etj. Projektligji parashikon rregullime të ngjashme me ligjin për nëpunësin civil, i cili madje plotëson kuadrin ligjor në këtë drejtim për çështje që ky projektligj nuk i parashikon. Nëpërmjet përfshirjes së stafit të gjykatave në një status të mirë rregulluar të quajtur nëpunës civil gjyqësor, do të krijohet mundësinë e konsolidimit dhe të rritjes së profesionalizmit dhe efikasitetit në sistemin gjyqësor.3.3.16. Sigurimi i vazhdimësisë së punonjësve aktualë dhe përcaktimi i rregullave për të kaluar në nëpunës civil gjyqësor. Projektligji parashikon rregullime për kalimin e statusit të punonjësve aktualë në gjykata në atë të nëpunësit civil gjyqësor. Qëllimi i projektligjit është garantimi i vazhdimësisë së punonjësve në detyrë duke fituar statusin e nëpunësit civil gjyqësor. Statusi i nëpunësve civil gjyqësor është një huazim i statusit të nëpunësve të shërbimit civil, me institute si emërimi, periudha e provës, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, rastet e pezullimit, transferimi, kriteret ligjore që duhet të plotësojnë për pozicionet e nëpunësve civil gjyqësor, përgjegjësia disiplinore, procedura e ndjekur dhe masat e marra, etj.”. Nga përmbajtja e këtij raporti del qartë qëllimi i legjislatorit që është garantimi i vazhdimësisë së punonjësve në detyrë duke fituar statusin e nëpunësit civil gjyqësor, për të ofruar kështu**

¹² Ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 33, datë 21.04.2014.

garanci, qëndrueshmëri, karrierë, profesionalizëm, ngritje të kapaciteteve etj. Statusi i nëpunësve civil gjyqësor është një huazim i statusit të nëpunësve të shërbimit civil, për rrjedhojë Këshilli i Gjykatës për sqarimin e kuptimit të këtij ligji do t'i referohet ligjit për statusin e nëpunësve të shërbimit civil.

13.1. Në nenin 1 germa “d” të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nën titullin “**Objekti**”, parashikohet shprehimisht se: **“1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe i rregullave në lidhje me: ...d) statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë. 2. Ky ligj zbatohet për çdo gjykatë me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatë të posaçme të krijuar me ligj.”**, ndërsa në nenin 2 pika “ë”, “g” dhe “j” të këtij Ligji nën titullin “**Përkufizime**” parashikohet shprehimisht se: **“Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ... ë) “Nëpunës civil gjyqësor” është personi, i cili ushtron funksione administrative publike brenda shërbimit gjyqësor ose administrativ të një gjykate në mbështetje të drejtpërdrejtë të sistemit gjyqësor....g) “Punonjës i gjykatës” është personi që kryen veprimtari të mirëmbajtjes, transportit, të ruajtjes dhe veprimtari të tjera në shërbime mbështetëse të gjykatës, që nuk kryhen nga nëpunësit civilë gjyqësorë. ...j) “Shërbim civil gjyqësor” është trupa e nëpunësve civilë gjyqësorë, që ushtron funksione administrative publike brenda shërbimit gjyqësor ose administrativ të një gjykate në mbështetje të drejtpërdrejtë të sistemit gjyqësor.”**. Gjithashtu, në nenin 8 të këtij Ligji nën titullin “**Parimet e shërbimit civil gjyqësor**” parashikohet shprehimisht se: **“1. Veprimtaria e shërbimit civil gjyqësor rregullohet me ligj dhe bazohet mbi parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit, transparencës, profesionalizmit, integritetit, përgjegjshmërisë dhe orientimit drejt shërbimeve efçente dhe të aksesueshme për çdo person. 2. Statusi i nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor mbështetet në parimin e garantimit të qëndrueshmërisë, bazuar në meritë dhe zhvillimin transparent të karrierës.”**, ndërsa në 9 të këtij Ligji nën titullin “**Zbatimi i ligjeve të tjera**”, parashikohet shprehimisht se: **“Dispozitat e këtij ligji plotësohen me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit “Për nëpunësin civil”, përveç rasteve dhe për aq sa në këtë ligj nuk parashikohet ndryshe.”**. Nga interpretimi literal, logjik dhe sistematik i këtyre dispozitave rezulton se nëpunësit civil gjyqësor veprojnë mbi të njëjtat parime sikurse funksionojnë nëpunësit civil në përgjithësi të administratës publike. Gjithashtu, për të bërë dallimin midis “nëpunësit civil gjyqësor” dhe “punonjësit të gjykatës” merret për bazë natyra e punës dhe profesionalizmi. Nga ky ligj del qartë se kush kryen detyrat në shërbimet gjyqësore dhe administrative të gjykatës konsiderohet nëpunës civil gjyqësor. Ndërkohë lidhur me shërbimet mbështetëse ligji sqaron se këto shërbime mund të kryen si nga punonjësit mbështetës të gjykatës ashtu dhe nga nëpunësit civil gjyqësor. Në këtë përfundim arrihet nga interpretimi logjik i togfjalëshit “Punonjës i gjykatës” është personi që kryendhe veprimtari të tjera në shërbime mbështetëse të gjykatës, që nuk kryhen nga nëpunësit civilë gjyqësorë.”. Pra, sipas këtij parashikimi veprimtari të tjera në shërbimet mbështetëse të gjykatës mund të kryen edhe nga nëpunës civil gjyqësor, kur natyra e punës kërkon aftësi dhe profesionalizëm që dikton kështu pasjen e arsimit të lartë¹³ si kusht për rekrutim, P.sh në

¹³ Gjithashtu, duke qënë se Ligji Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar plotësohen me dispozitat e Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, Këshilli i Gjykatës çmon t'i referohet edhe këtij ligji, për të bërë dallimin midis shërbimeve civile gjyqësore dhe atyre mbështetëse. Kështu, në nenin 4 të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, nën titullin “**Përkufizime**”, parashikohet shprehimisht se: **“1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ...c) “Nëpunës civil” është personi**

VKM-në Nr. 607, datë 11.6.2009 është parashikuar struktura dhe niveli i pagës së punonjësit me arsim të lartë të administratës gjyqësore, në pozicionin “Përgjegjës i shërbimeve mbështetëse”, në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit. Ky pozicion pune duhet kualifikuar sipas ligjit si një veprimtari mbështetëse që kryen nga nëpunësi civil gjyqësor dhe jo nga punonjësi mbështetës i gjykatës. Për të përcaktuar pozicionet e punës që futen tek shërbimet mbështetëse për të cilat nuk kërkohet arsim i lartë si kërkesë e vendit të punës, Këshilli i Gjykatës çmon t’i referohet nenit 2 pika 4 të Ligjit Nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblymimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të krijuara me ligj”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht: *“Në kuptim të këtij ligji: ...4. **“Punonjës mbështetës” janë punonjësit, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës dhe që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, si sekretarë, përveç sekretarëve të funksionarëve politikë dhe funksionarëve të lartë të shtetit, operatorë, teknikë të mesëm të specialiteteve të ndryshme, punonjës pastrimi, nëpunës informacioni, roje, shoferë etj.**”*. Pra, sipas kësaj dispozite nëse personi që kryen detyra të karakterit mbështetës nuk është teknik i mesëm, pasi për shkak të natyrës së veçantë të punës kërkohet arsim i lartë, nuk kualifikohet si punonjës mbështetës, por kualifikohet si nëpunës civil gjyqësor, si dhe marrëdhëniet e punës së tyre nuk mund të rregullohen me Kodin e Punës.

13.2. Gjithashtu, në Ligjin Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është parashikuar organizimi i administratës gjyqësore, si dhe kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë. Kështu, në nenin 41 të këtij Ligji nën titullin **“Organizimi i administratës gjyqësore”** parashikohet shprehimisht se: *“1. Administrata gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve të mëposhtme: a) **shërbime gjyqësore**, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë gjyqësore, duke përfshirë dokumentimin dhe veprimtari që kryhen nga këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, kryesekretarja dhe sekretarët gjyqësorë; b) **shërbime administrative**, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin gjyqësor, sigurinë, si dhe burimet njerëzore; c) **shërbime mbështetëse**, që sigurojnë në mënyrë të veçantë kryerjen e shërbimeve të njoftimeve, dhënien ndihmë trupit gjykues dhe kryesuesit të seancës, si dhe çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me rregullin dhe sjelljen e përshtatshme gjatë seancës gjyqësore, shërbimet e transportit, mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës. 2. Veprimtaritë që duhet të kryhen rregullisht për secilin nga këto shërbime përcaktohen në përshkrimin standard të punës, të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.”*, ndërsa në nenin 50 të këtij Ligji nën titullin **“Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë”**, parashikohet shprehimisht se: *“1. Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë janë: a) kancelari; b) këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë; c) ndihmësi ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit; ç) kryesekretari; d) sekretari gjyqësor; dh) nëpunësi i financës dhe buxhetit; e) nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhëniet me publikun, me jashtë ose*

*që kryen funksionin për ushtrimin e autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre...d) **“Punonjës administrativ”** është punonjësi që kryen veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtjeje, shërbimi, ruajtjeje dhe nuk ushtron një funksion publik.”* Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se nëpunësit civil ushtrajnë funksionet e tyre në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit, për të cilët kërkohet se kërkesë e posaçme për vendim e punës arsimit i lartë dhe që ushtron një funksion publik.

me median. 2. Statusi i nëpunësve civilë gjyqësorë rregullohet nga ky ligj.”. Ndërkohë në nenin 51 të këtij Ligji nën titullin “**Punonjësit e tjerë gjyqësorë**” parashikohet shprehimisht se: “*Marrëdhënia e punës e punonjësve të tjerë në gjykatë rregullohet nga Kodi i Punës.*”. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se administrata gjyqësore ndahet në tre shërbime të cilat janë: **i)** shërbimet gjyqësore; **ii)** shërbimet administrative dhe **iii)** shërbimet mbështetëse. Gjithashtu, sipas këtyre dispozitave në administratën gjyqësore ka vetëm dy kategori punonjësish të cilët janë: **i)** nëpunësit civilë gjyqësorë; dhe **ii)** punonjësit e tjerë të gjykatës të cilët janë punonjësit mbështetës si: operatorë, teknikë të mesëm të specialiteteve të ndryshme, punonjës pastrimi, nëpunës informacioni, roje, shoferë etj. **Këshilli i Gjykatës çmon se kategoria e nëpunësve civil gjyqësor nuk është shteruese, pra nuk janë vetëm punonjësit që përmenden në nenin 50 të këtij ligji. Kjo për arsyet si më poshtë vijon:**

13.2.1. Së pari, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se **normat ligjore nuk mund të interpretohen si norma të izoluara, por duhen parë në harmoni me normat e tjera ligjore. Një qëndrim i tillë bazohet në faktin se asnjë dispozitë e ligjore nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete, pasi çdo dispozitë ligjore duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese**, kjo për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik, pa kontradikta të brendshme¹⁴ Gjithashtu, është detyrë e organit procedues që në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën dhe të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, organi procedues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues¹⁵ dhe parimet mbi bazën e të cilëve udhëhiqet shërbimi civil gjyqësor. Bazuar në interpretimin logjik dhe sistematik të dispozitave të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Gjykatës çmon se, në zbatim të nenit 107 të Kushtetutës janë parashikuar parimit mbi bazën e të cilit funksionin shërbimit civil gjyqësor, ku një ndër parimet është ai i garantimit të qëndrueshmërisë. Për shkak të rëndësisë që kanë disa prej pozicioneve të punës që janë pjesë e administratës gjyqësore, vetë legjislatori është kujdesur t’i përmendi shprehimisht në ligj si kategori të nëpunësve civil gjyqësor. Qëllimi i ligjvënësit për kategorit e nëpunësve civil gjyqësor që përmenden në mënyrë nominale në nenin 50 të Ligjit Nr. 98/2016 është për t’i dhënë stabilitet e qëndrueshmëri këtyre pozicioneve, pasi janë vlerësuar thelbësore për ekzistencën e tyre në strukturën e çdo gjykate. Kjo do të thotë se, Këshilli i Gjykatës nuk mund të suprimoj dhe nuk ka sesi mos t’i parashikojë këto pozicione punë në strukturën e gjykatës si nëpunës civil gjyqësor, por kursesi kjo dispozitë nuk mund të interpretohet si një dispozitë që ndalon Këshillin e Gjykatës që në respektim të parimit të pavarësisë organizative të përcaktojë dhe punonjës të tjerë sipas kërkesave dhe nevojave specifike për burimet njerëzore në gjykata. Nëse qëllimi i legjislatorit do të ishte që të kishte vetëm një listë shteruese për nëpunësit civil gjyqësor atëherë nuk do të kishte sens logjik dhe juridik që të parashikohet në ligj: **i)** përkufizimi i “nëpunësit civil gjyqësor” dhe kriteret ligjore që duhet të përmbushin këta

¹⁴ Shiko vendimin Nr. 16, datë 10.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁵ Shiko vendimin Nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

të fundit për t'u konsideruar si të tillë; **ii**) përkufizimi i “punonjësit të gjykatës” dhe kriteret ligjore që duhet të përmbushin këta të fundit për t'u konsideruar si të tillë. Këshilli i Gjykatës çmon se, sqarimi i kuptimit të “nëpunësit civil gjyqësor” dhe “punonjësit të gjykatës”, është bërë me qëllim për t'u mbajtur në konsideratë nga Këshillat e Gjykatës në parashikimin në strukturën e gjykatës të punonjësve të tjerë sipas kërkesave dhe nevojave specifike për burimet njerëzore të gjykatave, të ndryshëm nga ata që listohen shprehimisht në nenin 50 të Ligjit Nr. 98/2016.

13.2.2. Së dyti, sikurse është theksuar më lartë në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, pavarësia e gjyqësorit kuptohet si *pavarësi substanciale*, që do të thotë “liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit”; *pavarësi strukturale* që lidhet me parashikimin në Kushtetutë apo në ligj të ekzistencës së institucionit, të mënyrës së formimit të përbërjes së tij; *pavarësi organizative* që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të gjykatave, që gjen shprehje edhe në të drejtën e tyre që të hartojnë e caktojnë vetë, në përputhje me kriteret të caktuara, strukturën dhe organikën e tyre, emërimin e funksionarëve të niveleve më të ulëta, rekrutimin e personelit në nivele të ndryshme, etj.¹⁶. Në respektim të parimit të pavarësisë organizative të gjykatave, në nenin 38 germa “a”, “b” dhe “c” të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nën titullin “**Kompetencat e Këshillit të Gjykatës**”, ku parashikohet shprehimisht se: “*Këshilli i Gjykatës ka kompetencat e mëposhtme: a) miraton përshkrimet e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor dhe punonjësve të gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe në raste të veçanta i përshtat me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës; b) merr vendime në lidhje me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë, siç përcaktohet në këtë ligj; c) miraton strukturën dhe organikën e administratës së gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe në raste të veçanta i përshtat me nevojat e gjykatës dhe aftësitë e personave në detyrë;...*”, është parashikuar se është në Kompetencë të Këshillit të Gjykatës që të miratoi përshkrimet e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor dhe punonjësve të gjykatës, si dhe të miratoi strukturën dhe organikën e administratës së gjykatës, duke i përshtatur me nevojat e saj dhe aftësitë e personave në detyrë. Pra, ky ligj është në përputhje me standardet kushtetuese duke garantuar pavarësinë organizative të gjykatave dhe krahas marrjes në konsideratë të modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor lidhur me përshkrimet e punës dhe strukturën, Këshillat e Gjykatës kanë pavarësi t'i përshtasin ato me nevojat e gjykatës. Kjo për faktin pasi kompetenca lëndore dhe organika ekzistuese e gjykatave dikton që struktura nuk mund të jetë identike në çdo gjykatë. Më përjashtim të nëpunësve civil gjyqësor që parashikohen shprehimisht në nenin 50 të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Gjykatës mund të përcaktojë dhe punonjës të tjerë sipas kërkesave dhe nevojave specifike për burimet njerëzore në gjykata. Natyrisht duke mbajtur në konsideratë kuptimin që i është dhënë “nëpunësit civil gjyqësor”, pra kriteret që duhet të plotësoj një pozicion pune për t'u konsideruar si i tillë që në asnjë rast nuk duhet të bëjë pjesë në kryerjen e shërbimeve që realizohen nga “punonjësit mbështet të gjykatës”. Ky qëndrim është mbajtur edhe me **vendimin Nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

¹⁶ Shiko vendimin Nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

Kështu, në nenin 2 të këtij vendimi, nën titullin “**Subjektet**” parashikohet shprehimisht se: “**Subjekte të këtij vendimi janë kandidatët për pozicionet e mëposhtme: a) kryesekretar; b) sekretar gjyqësor; c) nëpunës i financës dhe i buxhetit; ç) nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit; d) nëpunës të burimeve njerëzore; dh) nëpunës të teknologjisë së informacionit; e) nëpunës të arkivit; ë) nëpunës të marrëdhënieve me publikun, me median dhe me jashtë; f) nëpunës të tjerë që punojnë në gjykata, sipas kërkesave dhe nevojave specifike për burimet njerëzore të gjykatave.”.**

Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se Këshilli i Lartë në respektim të parimit të pavarësisë organizative të gjykatave, si dhe në interpretim korrekt të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk e konsideron shteruese listën e “nëpunësve civil gjyqësor” parashikuar nga neni 50 i këtij ligji, por rast pas rasti sipas kërkesave dhe nevojave specifike për burimet njerëzore të gjykatave, në strukturën e gjykatës mund të ketë edhe parashikohen dhe pozicione të tjera pune. Këshilli i Gjykatës çmon se, çdo interpretim tjetër do të bënte që të cenohet në thelb pavarësia organizative e çdo gjykate. Nuk mund të ketë pavarësi të gjykatës pa garantimin e të gjithë komponentëve të pavarësisë: **i) pavarësi substanciale; ii) pavarësi strukturale; iii) pavarësi organizative; iv) pavarësi financiare dhe v) pavarësi personale.**

13.2.3. Së treti, me vendimet Nr. 556, datë 29.12.2022 “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”; **Nr. 148, datë 29.03.2023** “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e Parë, me Zyrë Shërbimi”; **Nr. 150, datë 29.03.2023** “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e dytë dhe e tretë me Zyra Shërbimi”, **të Këshillit të Lartë Gjyqësor ndër të tjera janë parashikuar dhe përshkrimet e punës si nëpunës civil gjyqësor të pozicioneve të punës: i) Specialist për Statistikat Gjyqësore dhe ii) Specialist i Prokurimit Publik.** Këto pozicione pune nuk parashikohen shprehimisht në kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë të parashikuar nga neni 50 i Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pra, edhe nëpërmjet këtyre vendimeve Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi kushtetues që garanton pavarësinë e gjyqësorit, konfirmon përsëri se neni 50 i Ligjit Nr. 98/2016 për kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë nuk mund të konsiderohet shterues. Këshilli i Gjykatës çmon se Këshilli i Lartë Gjyqësor edhe nëpërmjet këtyre vendim marrjeve ka respektuar parimin e pavarësisë organizative të gjykatave për t’i lënë hapësirën e garantuar nga ligji që të parashikojnë pozicione pune sipas kërkesave dhe nevojave specifike për burimet njerëzore të gjykatave. Gjithashtu, në nenin 9 të **vendimit Nr. 298, datë 30.05.2023** “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës të Parë Tiranë”, **të Këshilli i Lartë Gjyqësor, nën titullin “Strukturat e shërbimeve administrative dhe mbështetëse”** parashikohet shprehimisht se: “**5. Shërbimet mbështetëse ushtrohen nga nëpunës civilë gjyqësorë, që kryejnë detyrat sipas përshkrimeve të punës bashkëlidhur kësaj rregullore dhe atyre të miratuara nga Këshilli i Gjykatës, si dhe nga punonjës të tjerë gjyqësorë që emërohen**

dhe shkarkohen nga Kancelari dhe marrëdhëniet e punës së tyre rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.” Këshilli i Gjykatës çmon se, gjithashtu, nëpërmjet këtij vendimi konfirmohet se ndonëse nëpunësi civil i shërbimeve mbështetëse nuk përmenden shprehimisht në nenin 50 të Ligjit Nr. 98/2016, Këshilli i Lartë Gjyqësor konfirmon se kjo liste nuk mund të konsiderohet shteruese, për rrjedhojë gjykatat mund të kualifikojnë si nëpunës civil gjyqësor edhe në sektorin e shërbimeve mbështetëse nëse kërkohet kualifikim i posaçëm për pozicionin e punës.

13.3. Gjithashtu, në Ligjin Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është rregulluar statusi i punonjësve të administratës gjyqësore në detyrë. Kështu, në nenin 86 të këtij Ligji nën titullin “**Dispozitë e veçantë për të punësuarit në Gjykatat e Krimeve të Rënda**” parashikohet shprehimisht se: “1. Të punësuarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda duhet të plotësojnë kushtet e sigurimit, të caktuara me ligj të veçantë, përfshirë dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake dhe për familjarët e afërm të tyre. Ndaj tyre zbatohen parashikimet e neneve 85¹⁷ dhe 87 të këtij ligji. 2. Këshillat e gjykatave për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar krijohen brenda dy javëve pas krijimit të gjykatave për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. **Këshillat e gjykatave për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar konfirmojnë të punësuarit në detyrë nëpërmjet një vendimi të shkruar, sipas parashikimeve të nenit 85, të këtij ligji, nëse i punësuarit në detyrë në gjykatë, si dhe familjarët e afërm të tij, japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, brenda dy javëve nga krijimi i gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.** 3. Në rastet kur i punësuarit ose nëpunësi civil në detyrë nuk konfirmohet nga Këshilli i Gjykatës, bazuar në arsye të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, atëherë dosja e punonjësit të gjykatës i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor, me qëllim vlerësimin e mundësive ekzistuese nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për sistemimin në një pozicion të lirë në një tjetër gjykatë, zyrë prokurorie, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë ose në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale të pozicionit të punës, dhe vetëm nëse nuk ka arsye për

¹⁷ Në nenin 85 të këtij Ligji nën titullin “**Statusi i punonjësve të tjerë në detyrë në gjykata**” parashikohet shprehimisht se: “1. Gjykata ngre Këshillin e Gjykatës brenda katër muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Brenda afatit 6-mujor nga krijimi i Këshillit të Gjykatës, **Këshilli i Gjykatës vlerëson plotësimin e kriterëve formale të punonjësve në detyrë për pozicionin që kryejnë, sipas këtij ligji, me përjashtim të kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor. Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Gjykatës vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër brenda administratës së gjykatës të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale nëse nuk ka arsye për përfundimin e marrëdhënieve të punës.** 2/1 Për sekretarët gjyqësorë në detyrë, që kanë mbi 3 vjet përvojë pune në këtë pozicion dhe janë me arsim të lartë, kriteri i diplomimit në drejtësi nuk përbën shkak për të mos njohur statusin e nëpunësit gjyqësor civil, nëse Këshilli i Gjykatës vlerëson pozitivisht performancën e tij në punë. 3. Punonjësi në detyrë në gjykatë ka të drejtë të dëgjohet, të paraqesë deklaratat dhe prova të tjera, si dhe të përfaqësohet. 4. **Kancelari i njofton vendimin me shkrim të arsyetuar të Këshillit të Gjykatës, të gjithë punonjësve të gjykatës brenda dy javëve nga data e vendimit të Këshillit të Gjykatës.** 5. Brenda dy javëve nga njoftimi, sipas parashikimit në pikën 4, të këtij neni, mund të bëhet ankim ndaj vendimit të Këshillit të Gjykatës në gjykatën kompetente. 6. **Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të detajuara për kritere të tjera që lidhen me specifikat e pozicionit të nëpunësve civilë, si dhe për procedurat me qëllim zbatimin e unifikuar të standardeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.**”

përfundimin e marrëdhënieve të punës. 4. Parashikimet e këtij neni nuk janë në kundërshtim me zbatimin e parashikimeve të nenit 88 të këtij ligji.”, ndërsa në nenin 87 të këtij Ligji nën titullin “**Vazhdimi ose përfundimi i kontratës së punës**”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rast se nuk bëhet ankim brenda afatit të parashikuar, **vendimi i Këshillit të Gjykatës për statusin e punonjësit në detyrë në gjykatë bëhet përfundimtar dhe kontrata e punësimit e punonjësit në detyrë, statusi i të cilit konsiderohet ai i nëpunësit civil gjyqësor, përfundon efektet në datën e fundit të afatit të ankimit.** Punonjësit e tjerë në gjykatë vazhdojnë të konsiderohen si të punësuar në përputhje me kontratën e punësimit, bazuar në Kodin e Punës. 2. Në rast se bëhet ankim, vendimi për statusin e nëpunësit në detyrë të gjykatës bëhet përfundimtar me vendimin gjyqësor të formës së prerë. **Në rast të njohjes së statusit të nëpunësit civil gjyqësor nga gjykata, kontrata e punësimit të nëpunësit përkatës në detyrë përfundon në ditën e njoftimit të vendimit gjyqësor përfundimtar.** Punonjësit e tjerë në gjykatë, ankimi i të cilëve nuk është njohur, vazhdojnë të konsiderohen si të punësuar, në përputhje me kontratën e punësimit, bazuar në Kodin e Punës. 3. **Punonjësit në detyrë, periudha e provës së të cilëve nuk ka përfunduar në datën kur bëhet përfundimtar vendimi për statusin e tyre, i nënshtrohen periudhës së provës, sipas kontratës së tyre të punësimit.** Dispozitat e këtij ligji për vlerësimin e punës dhe për vendimin në fund të periudhës së provës zbatohen për çdo nëpunës civil gjyqësor në provë.”. Nga interpretimi logjik dhe sistematik i këtyre dispozitave lidhur me të punësuarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda arrihet në këto përfundime: **i)** marrëdhënia e tyre është rregulluar me Kodin e Punës para hyrjes në fuqi të këtij ligji; **ii)** Këshillat e gjykatave për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar konfirmojnë të punësuarit në detyrë nëpërmjet një vendimi të shkruar, sipas parashikimeve të nenit 85, të këtij ligji, nëse i punësuarit në detyrë në gjykatë, si dhe familjarët e afërm të tij, japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, brenda dy javëve nga krijimi i gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar; **iii)** Konfirmohen në detyrë vetëm punonjësit që plotësojnë kriteret formale sipas nenit 56 të këtij ligji; **iv)** vendimi i Këshillit të Gjykatës për statusin e punonjësit në detyrë në gjykatë bëhet përfundimtar dhe kontrata e punësimit e punonjësit në detyrë, statusi i të cilit konsiderohet ai i nëpunësit civil gjyqësor, përfundon efektet në datën e fundit të afatit të ankimit që është brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit.

13.3.1. Në zbatim të pikës 85 pika 6, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është miratuar vendimi Nr. 338, datë 24.9.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kështu, në nenin 4 të këtij vendimi nën titullin “**Kriteret**” parashikohet shprehimisht se: “1. **Punonjësit në detyrë i jepet statusi i nëpunësit civil gjyqësor, nëse përmbush kriteret e klasifikuara si më poshtë: a) të përgjithshme; b) të veçanta.** 2. **Kriteret e përgjithshme janë: a) të jetë shtetas shqiptar; b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur; ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse; d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje; dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit; 3. Kriteret e veçanta janë: ...b) **për pozicionin e sekretarit gjyqësor: a) të jetë diplomuar në drejtësi, të paktën në nivelin “Bachelor”;** b) të ketë**

përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën ...d) **për pozicionet drejtuese si nëpunës civil gjyqësor**, në fusha të tjera të shërbimeve administrative të gjykatës: i. të jetë i diplomuar në drejtësi, ekonomi ose teknologji e informacionit ose shkenca komunikimi/gazetari, ose në fusha të tjera të përshtatshme me përshkrimin e punës, të paktën në nivelin “Master Shkencor” ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë; ii. të ketë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën. dh) **për punonjësit në detyrë në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, duhet të plotësohen edhe kushtet e sigurimit, të caktuara me ligj të veçantë, si dhe të jepet pëlqimi për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar prej punonjësit dhe familjarëve të afërm të tij.**”, ndërsa në nenin 6 të këtij vendimi nën titullin **“Procedura për dhënien e statusit”**, parashikohet shprehimisht se: *“1. Njësia e burimeve njerëzore në Gjykatë ose punonjësi përgjegjës, nën mbikëqyrjen e Kancelarit, brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit për plotësimin e dosjes personale, i paraqet Këshillit të Gjykatës listën e plotë të punonjësve në detyrë, së bashku me dosjen përkatëse. 2. Këshilli i Gjykatës, brenda një afatit 45 ditë nga marrja e dokumentacionit të mësipërm, bën verifikimin e plotësimit të kriterëve formale, për të gjithë punonjësit në detyrë, sipas nenit 2 të këtij vendimi. Verifikimi i plotësimit të kriterëve formale bëhet nga Këshilli i Gjykatës, sipas procedurës së parashikuar në nenin 28, të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”. 3. Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Gjykatës i komunikon atij gjetjet dhe i shpjegon të drejtat për t’u dëgjuar, për të paraqitur deklarata dhe prova të tjera, si dhe për t’u përfaqësuar, duke i caktuar dhe një afat, jo më shumë se 7 ditë, brenda të cilit duhet të përgjigjet me shkrim. Punonjësi në detyrë ka të drejtë të kërkojë dëgjimin e tij nga Këshilli i Gjykatës brenda 3 ditëve nga njoftimi i gjetjes. Këshilli i Gjykatës cakton një seancë dëgjimore nga marrja e njoftimit të kësaj kërkesë. 3/1. Për sekretarët gjyqësorë në detyrë, që kanë mbi 3 vjet përvojë pune në këtë pozicion dhe janë me arsim të lartë, kriteri i diplomimit në drejtësi nuk përbën shkak për të mos njohur statusin e nëpunësit gjyqësor civil, nëse Këshilli i Gjykatës vlerëson pozitivisht performancën e tij në punë. 4. Këshilli i Gjykatës, në përfundim të procedurës, vendos: a) dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor; b) mosdhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor.”* Ndërkohë në nenin 7 të këtij vendimi nën titullin **“Sistemimi në një pozicion tjetër”** parashikohet shprehimisht se: **“1. Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Gjykatës vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër, brenda administratës së gjykatës, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale, nëse nuk ka arsye për përfundimin e marrëdhënieve të punës.** 2. Sistemimi në një pozicion tjetër brenda administratës së gjykatës bëhet pas përfundimit të të gjithë procedurave për dhënien e statusit. Këshilli i Gjykatës, për sistemimin e punonjësit në një pozicion tjetër mban parasysht dhe vjetërsinë e punës në sistemin gjyqësor. 3. Në rastet kur punonjësi në detyrë, në Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, nuk konfirmohet nga Këshilli përkatës i Gjykatës, bazuar në arsye të përcaktuara në pikën 2, të nenit 86, të ligjit nr. 98/2016, atëherë dosja e punonjësit në detyrë i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të parashikimeve të pikës 3, të nenit 86, të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”.¹⁸ Nga përmbajtja

¹⁸ Ky vendim ka hyrë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare Nr. 175, datë 01.10.2020.

e këtij vendimi rezulton se, nëpunësit civil në detyrë që nuk plotësojnë kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Gjykatës vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër, brenda administratës së gjykatës, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale.

14. Gjithashtu, punonjësit e administratës gjyqësore me arsim të lartë, kur kjo është kërkesë e pozicionit të punës, janë trajtuar me **vendimin Nr. 187, datë 8.3.2017 të Këshillit të Ministrave** “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa Institucione të Pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”.¹⁹ Kështu, në pikën 1 dhe 1/1 të këtij vendimi parashikohet shprehimisht: “1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen: 1/1....., **administrata gjyqësore e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, administrata e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit, Gjykata e Lartë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**”. Gjithashtu, pjesë e këtij vendimi është Lidhja Nr. 4/1 me titull “**Kategorisë e pagave të punonjësve me arsim të lartë të administratës gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit dhe të administratës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit**”. Në këtë lidhje është parashikuar shprehimisht kategoria e pagës për pozicionet e punës “Përgjegjës i Shërbimeve Mbështetëse në Gjykatën e Krimeve të Rënda”, “Kryesekretar gjyqësor”, “Kryetar dege”, “Sekretar gjyqësor” dhe “Specialist”. Pra, sipas kësaj VKM-je specialistët e shërbimeve mbështetëse në Gjykatën e Krimeve të Rënda janë konsideruar si punonjës me arsim të lartë dhe që duhet të jetë kërkesë e vendit të punës.

14.1. Gjithashtu, në rastin konkret Këshilli i Gjykatës çmon t’i referohet **vendimit Nr. 919, datë 25.11.2020 të Këshillit të Ministrave** “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar. Në pikën 1, germa “a” të kësaj VKM-je, citohet shprehimisht: “1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon: a) Në pikën 1/1: **i. fjalët “... administrata gjyqësore e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, administrata e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit ...” zëvendësohen me fjalët “... nëpunësit civilë gjyqësorë dhe nëpunësit civilë të prokurorisë”;...**”, ndërsa në pikën “e” të kësaj VKM-je citohet shprehimisht se: “e) **Pika 7/1 ndryshohet, si më poshtë vijon: “7/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, si dhe nëpunësve civilë të prokurorisë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, janë sipas lidhjes nr. 4/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.**”. Ky vendim ka hyrë në fuqi ditën e botimit të tij në Fletoren Zyrtare Nr. 208, datë 27.11.2020. Kjo do të thotë që në administratën gjyqësore ka vetëm dy kategori

¹⁹ Ky vendim ka qenë në fuqi deri më datë 31.05.2023 me miratimin e VKM-së Nr. 325, datë 31.05.2023.

punonjësish që prej kësaj date, të cilat janë: **1)** punonjësit me arsim të lartë në administratën gjyqësore që kualifikohen si “nëpunës civil gjyqësor”, nëse arsimi i lartë është kërkesë e pozicionit të punës; dhe **2)** punonjësit mbështetës që trajtohen në këtë periudhë me VKM-në nr. 234, datë 20.4.2022, “*Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike*”, i ndryshuar. Pra, sipas kuadrit ligjor në fuqi për punonjësit e administratës gjyqësore nuk ka një status të ndërmjetëm. Ka vetëm dy kategori punonjësish të cilët janë: **i)** nëpunësit civil gjyqësorë dhe **ii)** punonjësit mbështetës që kryejnë veprimtari të mirëmbajtjes, transportit, të ruajtjes dhe veprimtari të tjera në shërbime mbështetëse të gjykatës, që nuk kryhen nga nëpunësit civilë gjyqësorë. **Kjo do të thotë që specialistët e shërbimeve mbështetëse pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për efekt të kësaj VKM-je e cila është e zbatueshme për efekt të pagës konsiderohen si “nëpunës civil gjyqësorë”.**²⁰ Që prej vitit 2009 e në vijim këta specialist asnjëherë nuk janë trajtuar për efekt të pagës sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës. Kjo në respektim korrekt të kuadrit ligjor, pasi këta specialist nuk kualifikohen në teknikë të mesëm të specialiteteve të ndryshme, punonjës pastrimi, nëpunës informacioni, roje, shoferë etj.

15. Në nenin 91 pika 4 të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nën titullin “**Aktet nënligjore**” parashikohet shprehimisht se: “4. *Të gjitha aktet nënligjore, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.*”. Këshilli i Gjykatës çmon se, urdhri Nr. 1830 datë 3.4.2001 i ministrit të Drejtësisë “*Për miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore”* nuk bie në kundërshtim me këtë ligj lidhur me detyrat e nëpunësit gjyqësor.²¹ Gjithashtu, në bazë dhe për zbatim të kësaj rregullore më urdhrin Nr. 115, datë 20.05.2015 të Kryetarit të Gjykatës është miratuar rregullorja e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë për krimet e rënda”, ku në nenin 21 të kësaj rregullore janë parashikuar detyrat e nëpunësit gjyqësor.²² Po ashtu, me vendimin Nr. 22, datë 29.12.2022 të Këshillit të Gjykatës është miratuar rregullore e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore të gjykatës së posaçme të

²⁰ I njëjtin parashikim është dhe në VKM-në Nr. 325, datë 31.5.2023. Kështu, në pikën 6/1, të kësaj VKM-je nën titullin “**II. KLASAT DHE NIVELET E PAGAVE E TË PAGESAVE TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE**” parashikohet shprehimisht: “6/1. *Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, si dhe nëpunësve civilë të prokurorisë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm janë sipas lidhjes nr. 7/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*”. Kjo VKM është aktualisht në fuqi.

²¹ Në nenin 22 të kësaj rregullore, nën titullin “**Nëpunësi gjyqësor**” parashikohet shprehimisht se: “*Nëpunësi gjyqësor në kryerjen e detyrave të tij bashkëpunon me sekretarin gjyqësor dhe sekretarin e seancës. Nëpunësi gjyqësor duhet të marrë pjesë në seancën gjyqësore dhe merr masa për zbatimin e urdhrave të gjykatës për njoftimin dhe futjen në sallë të dëshmitarëve, ekspertëve dhe kërkon nga ata solemnitet e respektim të trupit gjykues. Orienton palët të vendosen para gjykatës, paditësi në krahun e djathtë të trupit gjykues, i padituri në të majtë me pamje përballë gjykatës. Po kështu i pandehuri në të majtë dhe përfaqësuesi akuzës në të djathtë të trupit gjykues. Njofton aktet me shkrim, telefon e kundrejt firmës së marrësit, kur është e mundur, dëshmitarët, ekspertët etj, sipas mënyrës së përcaktuar në procedurën civile e penale, dhe, në çdo rast, tregon kujdes për eliminimin e shkaqeve të pavlefshmërisë së njoftimeve e të akteve. Aktet e njoftuara para datës së caktuar për seancën gjyqësore i dorëzon te sekretari seancës përkatës.*”.

²² Shiko nenin 21 të kësaj rregullore.

shkallës së parë për korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ku në nenin 23 të kësaj rregullore janë parashikuar detyrat e nëpunësit gjyqësor. Pra, përshkrimi i punës për nëpunës gjyqësor është parashikuar në këto akte, ku Këshilli i Gjykatës çmon të theksojë se janë pothuajse të njëjtat detyra që janë parashikuar për nëpunësin gjyqësor në nenin 26 të Ligjit Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, ku nëpunësit gjyqësor janë kualifikuar si **“nëpunës civil gjyqësorë”**.

16. Mbështetur në faktet e mësipërme, Këshilli i Gjykatës çmon se, z. Griselt Marku, i cili ushtron detyrën e “Nëpunësit gjyqësor” pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i plotëson të gjitha kushtet sipas kuadrit ligjor për t’u kualifikuar si “Nëpunës civil gjyqësor”. Kjo për këto arsye:

Së pari, nëpunësi gjyqësor kryen detyra procedurale dhe detyra të tjera me natyrë administrative, të përcaktuara në legjislacionin procedural gjyqësor në fuqi duke respektuar rreptësisht vendimet dhe urdhrat e nxjerra nga gjyqtarët brenda kompetencave të tyre gjyqësore.

Së dyti, nëpunësi gjyqësor është pjesë e shërbimeve gjyqësore, pra pjesë e shërbimeve gjyqësore të gjykatës dhe gjatë ushtrimit të detyrës ai bashkëpunon me kryesekretarin gjyqësor dhe sekretarin gjyqësor. Pra, nëpunësi gjyqësor nuk ka qenë asnjëherë pjesë e shërbimeve mbështetëse si strukture apo pjesë e zyrës administrative. Aktualisht në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nëpunësi gjyqësor kryen të njëjtat funksione që kanë kryer që prej vitit 2001.

Së treti, sipas **vendimit Nr. 20, datë 09.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese** rezulton se funksionet e sekretariatit të gjykatës dhe ajo e **nëpunësit gjyqësor luajnë një rol të rëndësishëm mbështetës për gjykatën dhe gjyqtarin në dhënien e drejtësisë**. Sipas këtij vendimi nëpunësit gjyqësor kryejnë veprimtari të natyrës procedurale.

Së katërti, në kuadrin e interpretimit historik të legjislacionit që ka rregulluar statusin e administratës gjyqësore, konkretisht sipas Ligjit Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, nëpunësi gjyqësor kryen detyra procedurale dhe detyra të tjera me natyrë administrative, të përcaktuara në legjislacionin procedural gjyqësor në fuqi, sipas parimeve të ligjshmërisë, paanshmërisë, si edhe të unitetit të veprimit e të varësisë hierarkike. Gjithashtu, sipas nenit 38 të këtij Ligji nëpunësi gjyqësor konsiderohet pjesë e shërbimit civil gjyqësor, duke plotësuar kushtet për të fituar statusin e nëpunësit civil gjyqësor, i cili funksionon sipas parimeve të profesionalizmit, paanshmërisë, integritetit, transparencës, qëndrueshmërisë, shërbimit për publikun, meritës dhe vazhdimësisë në karrierë, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi. Po ashtu, sipas nenit 42 të këtij Ligji nëpunësit gjyqësorë duhet të kenë diplomë të nivelit të parë të arsimit të lartë.

Së pesti, duke qenë kërkesë pasja e arsimit të lartë, për pozicionin e punës “Nëpunës gjyqësor” nuk mund të konsiderohen punonjës mbështetës, por që më miratimin e **Vendimit nr. 607, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave** “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë të administratës gjyqësore, të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të

apelit, si dhe punonjësve me arsim të lartë të administratës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit”, duheshin trajtuar si punonjës të gjykatës me arsim të lartë. Kjo për faktin pasi jo vetëm që arsimi i lartë për nëpunësit gjyqësor ka qenë kërkesë e veçantë e vendit të punës, por dhe natyra e punës nuk kualifikohet tek shërbimet mbështetëse, pasi gjithmonë pozicioni i punës “Nëpunës gjyqësor” ka qenë pjesë e zyrës së gjykatës apo pjesë e shërbimeve gjyqësore.

Së gjashti, sipas **vendimit Nr. 10 datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese** roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor. Funksionet që kryen administrata gjyqësore, ku bëjnë pjesë edhe nëpunësit gjyqësorë, veçanërisht në shërbimin ndaj publikut, përfshihen në kuptimin e funksionit publik, sipas përcaktimit që Kushtetuta jep në nenin 107 të saj.

Së shtati, bazuar në përkufizimin që jepet për “nëpunësin civil gjyqësor” në nenin 2 pika “ë” të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nëpunësit gjyqësorë i plotësojnë të gjitha kushtet për t’u konsideruar “*Nëpunës civil gjyqësor*” i cili është personi, i cili ushtron funksione administrative publike brenda shërbimit gjyqësor ose administrativ të një gjykate në mbështetje të drejtpërdrejtë të sistemit gjyqësor. Ky përkufizim është i ngjashëm me përkufizimin e dhënë nga Ligji Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, ku “Nëpunësin gjyqësor” në mënyrë eksplicite e ka konsideruar për shkak të ligjit si “Nëpunës civil gjyqësor”.

Së teti, në respektim të nenit 4 të vendimit Nr. 338, datë 24.9.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëpunësi gjyqësor në detyrë z. Griselt Marku i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pozicionin e punës. Kështu, nga aktet e administruara rezulton se, ai ka arsim të lartë juridik dhe ka mbi një vit përvojë profesionale në gjykatë. Lidhur me kriteret e arsimit për pozicionin e punës “Nëpunës gjyqësor” kërkohet i njëjti nivel arsimor me sekretaret gjyqësore, pra arsim i lartë “*Bachelor*”. Gjithashtu, nëpunësi gjyqësor apo “Specialisti i Shërbimeve Gjyqësore” ka dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar prej punonjësit dhe familjarëve të afërm të tij. Për këtë punonjës pritet vetëm përfundimi i rezultatit të verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Komisioni i Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës sipas neneve 6 dhe 57 të Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i ndryshuar.

17. Gjithashtu, me Nr. 7, datë 13.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin Nr. 6, datë 07.07.2023, “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe për miratimin e përshkrimeve të detyrave dhe përgjegjësisë të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të

Këshillit të Gjykatës është vendosur: “**1.** Në vendimin nr. 6, datë 07.07.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” të Këshillit të Gjykatës, bëhen ndryshime në strukturën organizative të administratës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas Lidhjes 1 dhe 2 të këtij vendimi. **2.** Miratimin e përshkrimeve të detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësorë të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas Lidhjes 3 të këtij vendimi. **3.** Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kancelari, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve. **4.** Dispozitat e Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, miratuar me vendimin Nr. 22, datë 29.12.2022 të Këshillit të Gjykatës, të cilat bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen. **5.** Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Këshillit të Lartë Gjyqësor. **6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**”. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi ndër të tjera citohet: [...]

87. Sikurse është arsyetuar në paragrafët 59, 59.1, 59.2, 59.3, 59.4, 59.5, 60, 61, 62, 63, 63.1, 64, 65, 65.1, 65.2, 65.2.1, 65.3, 65.4, 66, 66.1, 66.2, 66.2.1, 66.2.2, 66.2.3, 66.3, 66.3.1, 67, 67.1, 68, 69, 70, 71, 71.1, 71.2, 72, 72.1, 72.2, 73, 73.1, 73.1.1, 73.1.2, 73.2, 74, 74.1, 75 dhe 76 të këtij vendimi pozicioni i punës “Nëpunës gjyqësor” ka plotësuar dhe plotëson kushtet për t’u konsideruar pjesë e shërbimit civil gjyqësor, për rrjedhojë punonjësit që janë rekrutuar me arsim të lartë për këtë pozicion pune, konsiderohen për efekt të akteve ligjore dhe nënligjore ndër vite si dhe ato në fuqi “Nëpunës civil gjyqësor”. Kështu, nëpunësi gjyqësor kryen detyra procedurale dhe detyra të tjera me natyrë administrative, të përcaktuara në legjislacionin procedural gjyqësor në fuqi duke respektuar rreptësisht vendimet dhe urdhrat e nxjerra nga gjyqtarët brenda kompetencave të tyre gjyqësore. Gjithashtu, nëpunësi gjyqësor është pjesë e shërbimeve gjyqësore, pra pjesë e shërbimeve gjyqësore të gjykatës dhe gjatë ushtrimit të detyrës ai bashkëpunon me kryesekretarin gjyqësor dhe sekretarin gjyqësor. Pra, nëpunësi gjyqësor nuk ka qenë asnjëherë pjesë e shërbimeve mbështetëse si strukture apo pjesë e zyrës administrative. Aktualisht në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nëpunësi gjyqësor kryen të njëjtat funksione që kanë kryer që prej vitit 2001. Në kuadrin e interpretimit historik të legjislacionit që ka rregulluar statusin e administratës gjyqësore, konkretisht sipas Ligjit Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, nëpunësi gjyqësor kryen detyra procedurale dhe detyra të tjera me natyrë administrative, të përcaktuara në legjislacionin procedural gjyqësor në fuqi, sipas parimeve të ligjshmërisë, paanshmërisë, si edhe të unitetit të veprimit e të varësisë hierarkike.

87.1.Në respektim të parimit të ligjshmërisë,²³parimit të drejtësisë dhe e paanësisë,²⁴ parimit të objektivitetit²⁵ dhe parimit të marrjes së vendimeve,²⁶ i cili duhet të udhëheq organin publik në ushtrimin e funksioneve të tij, **Këshilli i Gjykatës, mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, çmon se, pozicioni i punës “Nëpunës gjyqësor” që në interpretim të gabuar të kuadrit ligjor është konsideruar si punonjës administrativ apo mbështetës, duhet të trajtohet si pozicion pune, pjesë e shërbimit civil pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke u konsideruar këta punonjës si “Nëpunës civil gjyqësor”. Gjithashtu, me qëllim harmonizimin e emërtimeve të pozicioneve të punës pranë kësaj gjykate me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, konkretisht VKM -në Nr. 325, datë 31.05.2023 që parashikon klasat e pagave vetëm për kategorinë e punonjësve “Kancelar”, “Drejtor Drejtorie me funksion nëpunës zbatues”, “Ndihmës ligjor”, “Drejtor i drejtorive mbështetëse”, “Kryesekretar”, “Përgjegjës/Shef sektori”, “Sekretar gjyqësor” dhe “Specialist”, Këshilli i Gjykatës çmon se duhet ndryshuar emërtimi i pozicionit të punës nga “Nëpunës Gjyqësor” në “Specialist i Shërbimeve Gjyqësore”. Po ashtu, duke qenë se natyra e punës që kryejnë aktualisht “Nëpunësit gjyqësorë” lidhet drejtpërdrejtë me shërbimet gjyqësore, në strukturën e re, “Nëpunësit gjyqësorë”, duhet të transferohen pranë shërbimeve gjyqësore e cila duhet të përbëhet nga: 1) Kryesekretaria; 2) Sekretarët gjyqësorë; dhe 3) Specialistët e Shërbimeve Gjyqësore. Ndërkohë për të gjitha arsyet e cituara në paragrafët 34, 35, 35.1, 36, 37, 38, 38.1, 38.2 dhe 38.3 të këtij vendimi pozicionin e punës “Specialist i Shërbimeve Gjyqësore” pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duhet të aplikohet klasa e pagës IV-1, sipas lidhjes 6/1 të VKM-së Nr. 325, datë 31.5.2023. ...**

90.1. Këshilli i Gjykatës në hartimin e përshkrimeve të detyrave dhe përgjegjësiive të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u mbështet në vendimin nr. 148/2023 "Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësiive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi" të Këshillit të Lartë Gjyqësor. **Gjithashtu, në**

²³ Në nenin 4 të K.Pr.Administrative, nën titullin “**Parimi i ligjshmërisë**” parashikohet shprehimisht se: “1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. 2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.”.

²⁴Në nenin 13 të K.Pr.Administrative, nën titullin “**Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë**” parashikohet shprehimisht se: “Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.”.

²⁵ Në nenin 14 të K.Pr.Administrative, nën titullin “**Parimi i objektivitetit**” parashikohet shprehimisht se: “Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën admini-strative.”.

²⁶Në nenin 16 të K.Pr.Administrative, nën titullin “**Parimi i marrjes së vendimeve**” parashikohet shprehimisht se: “Në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, një organ publik merr vendime për të gjitha çështjet e ngritura nga një palë, të cilat janë në kompetencë të tij.”.

respektim të parimit të pavarësisë organizative të gjykatave, Këshilli i Gjykatës, bazuar në nenin 38 germa “a”, “b” dhe “c” të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, përshtati përshtatjet e punës me nevojat e gjykatës dhe aftësitë e personave në detyrë, konkretisht për pozicionet e punës “*Specialist i Shërbimeve Gjyqësore*” dhe “*specialist pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve*”, të cilët hynë në kategorinë e nëpunësve civil gjyqësorë. [...]

18. Nga përmbajtja e vendimit të mësipërm, mbështetur në pikën 38 dhe 40 të VKM-së Nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “**38. Urdhri për miratimin e strukturës hyn në fuqi menjëherë**, por fillon të prodhojë efektet financiare jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi, **periudhë në të cilën duhet të përfundojnë të gjitha veprimet për sistemimin e punonjësve ekzistues në strukturën e re...**”, rezulton se **miratimi i strukturës organike të ndryshuar të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, ku është ndryshuar emërtimi i pozicionit të punës nga “Nëpunës Gjyqësor” në “*Specialist i Shërbimeve Gjyqësore*”, i cili hynë në kategorinë e “Nëpunësit civil gjyqësor”, **ka hyrë në fuqi menjëherë**. Ndodhur në këto kushte, Këshilli i Gjykatës duhet të përfundojë të gjitha veprimet për sistemimin e punonjësve ekzistues në strukturën e re. Pra, në rastin konkret, Këshilli i Gjykatës duhet të marrë në analizë faktin nëse z. Griselt Marku duhet të caktohet në mënyrë të përhershme në strukturën e re si nëpunës civil gjyqësor apo duhet caktohet në mënyrë të përkohshme si nëpunës civil gjyqësor, nisur nga fakti që për punonjësit në detyrë në Gjykatat e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, duhet të plotësohen edhe kushtet e sigurimit, të caktuara me ligj të veçantë, si dhe të jepet pëlqimi për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar prej punonjësit dhe familjarëve të afërm të tij.

19. Për t’i dhënë zgjidhje kësaj situatë faktike juridike, Këshilli i Gjykatës çmon t’i referohet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në funksion të interpretimit të normave ligjore. Kështu, në vendimin Nr. 28, datë 16.12.2008 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera arsyeton: “Në bazë të këtij parimi gjykata duhet të kërkojë gjithmonë brenda rendit juridik të shtetit shqiptar normën që rregullon një rast konkret. Ajo duhet të mbështetet në një autoritet që ka forcën e ligjit dhe që zgjidh mosmarrëveshjen konkrete. Në rast se një normë e tillë nuk ekziston ajo duhet të kërkojë edhe norma të tjera që rregullojnë rastet analoge. Gjykata, **për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ka detyrën funksionale për të kryer interpretime të ndryshme në lidhje me kuptimin e normave, me kërkimin e normave që rregullojnë rastet analoge apo me identifikimin e parimeve të përgjithshme dhe të jurisprudencës kushtetuese.**”, ndërsa në vendimin Nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera arsyetohet: “...në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t’i drejtohet Gjykatës **duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën** (shih vendimin nr.55, datë 21.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që

përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej.”. Nga përmbajtja e këtyre vendimeve rezulton se, për të zgjidhur një çështje të caktuar organi procedues duhet ndër të tjera t’i referohet normave që rregullojnë rastet analoge si dhe t’i referohet parimeve të përgjithshme dhe jurisprudencës kushtetuese.

19.1. Gjithashtu, në rastin konkret, Këshilli i Gjykatës çmon se në kuadrin e reformës në drejtësi, konkretisht në krijimin e institucioneve është respektuar parimi i vazhdimësisë institucionale. Kështu, në vendimin Nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera arsyetohet se: **“60. Gjykata vëren se normat e mësipërme ligjore rregullojnë vazhdimësinë e statusit dhe qëndrimin në detyrë sipas mandatit të mëparshëm të gjyqtarëve të niveleve apo kategorive të ndryshme, duke përfshirë magistratët në Gjykatën e Lartë, gjyqtarët në Gjykatat e Krimeve të Rënda,Referuar përmbajtjes së tyre, Gjykata konstaton se dispozitat kalimtare e lidhin vijimësinë e detyrës së magistratit me plotësimin e dy kriterëve që përfshijnë “me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII, të këtij ligji” dhe rezultatet e rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. 61. Ashtu siç u shpreh edhe më sipër, Gjykata rithekson se fryma që përshkon Kushtetutën edhe pas ndryshimeve kushtetuese është vazhdimësia institucionale dhe ushtrimi i funksioneve, me qëllim garantimin e vlerave dhe parimeve që qëndrojnë në themel të shtetit të së drejtës....””.**

19.1.2. Parimi i vazhdimësisë institucionale dhe ushtrimi i funksioneve, si dhe parimi i funksionalitetit është parashikuar në nenin 162 të Ligjit Nr. 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, i ndryshuar, nën titullin **“Dispozita kalimtare për Gjykatat e Krimeve të Rënda”**, parashikohet shprehimisht se: **“2. Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton në mënyrë të përhershme gjyqtarët në detyrë në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me kërkesë të tyre, nëse: a) gjyqtari kalon me sukses procesin e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; b) përmbush kriteret për ngritjen në detyrë, sipas përcaktimeve të nenit 47 të këtij ligji; c) gjyqtari, si dhe familjarët e afërm të tij japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. 3. Nëse ndaj gjyqtarit në detyrë të Gjykatës së Krimeve të Rënda ka filluar procesi i rivlerësimit në shkallë të parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendim të formës së prerë, dy javë pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton gjyqtarin përkohësisht në nivelin përkatës në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me kusht që ai, si dhe familjarët e afërm të tij të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar””. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, fillimisht gjyqtarët në detyrë pranë gjykatave të posaçme caktohen përkohësisht kur ka filluar procesi i vettingut nëse ai, si dhe familjarët e afërm të tij japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të**

telekomunikimeve vetjake. Më pas nëse gjyqtari kalon me sukses procesin e rivlerësimit dhe përmbush kriteret për ngritjen në detyrë Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton në mënyrë të përhershme gjyqtarët në detyrë në gjykatën e posaçme.

20. Duke u rikthyer në rastin konkret, sikurse u theksua më lartë në respektim të nenit 4 të vendimit Nr. 338, datë 24.9.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Griselt Marku i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pozicionin e punës për sa i përket arsimit e përvojës profesionale. Kështu, nga aktet e administruara rezultojnë se, nëpunësi gjyqësor në detyrë ose “Specialist i shërbimeve gjyqësore” me emërtimin e ri, ka arsim të lartë juridik si dhe ka mbi një vit përvojë profesionale në gjykatë. Lidhur me kriteret e arsimit për pozicionin e punës “Nëpunës gjyqësor” kërkohen i njëjti nivel arsimor me sekretaret gjyqësore, pra arsim i lartë “*Bachelor*”. Gjithashtu, nëpunësi gjyqësor apo “specialisti i shërbimeve gjyqësore” ka dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar prej punonjësit dhe familjarëve të afërm të tij. Për këtë punonjës pritet vetëm përfundimi i rezultatit të verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës sipas neneve 6 dhe 57 të Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i ndryshuar.

21. Megjithatë, Këshilli i Gjykatës çmon të theksoj se statusi i “Nëpunësit civil gjyqësor” në pozicionin e punës “*Specialist i Shërbimeve Gjyqësore*”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për punonjësit në detyrë mund të bëhet i përhershëm vetëm nëse kalohet me sukses verifikimi i pasurisë dhe figurës nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës. Ndodhur në këto kushte, Këshilli i Gjykatës çmon se, për punonjësit në detyrë që i plotësojnë të gjitha kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të kualifikimit lidhur me arsimin e përvojën profesionale, por që nuk i ka përfunduar procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës, duhet zbatuar me analogji neni 162 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pra, në rastin konkret punonjësit në detyrë, në pozicionet e punës që kualifikohen si “Nëpunës civil gjyqësor” sikurse është pozicioni i punës “*Specialist i Shërbimeve Gjyqësore*” duhet të caktohen fillimisht në mënyrë të përkohshme për të ushtruar detyrën si “*Nëpunës civil gjyqësor*” dhe statusi i tyre do të bëhet përfundimtar, për rrjedhojë do të caktohen në mënyrë të përhershme në pozicionin e punës ku janë caktuar përkohësisht, vetëm pas administrimit të vendimit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës që konfirmon kalimin me sukses të verifikimit të pasurisë e figurës.

21.1. Nëpërmjet kësaj vendimmarrje garantohet parimi i vazhdimësisë institucionale dhe parimi i funksionalitetit të gjykatës, pasi në çdo interpretim tjetër duke marrë në konsideratë kohën që duhet për të bërë verifikimin e pasurisë dhe figurën do të bënte që institucioni të mos funksiononte, duke mos ofruar shërbime gjyqësore, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë gjyqësore si dhe shërbimet administrative. Lidhur me rolin dhe rëndësinë e administratës gjyqësore, Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 46, datë 29.06.2015, ndër të tjera arsyeton se: “14. Gjykata rithekson se roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor.”. Gjithashtu, Këshilli i Gjykatës çmon se, gjatë periudhës së verifikimit të pasurisë dhe

figurës, të gjithë nëpunësit civil gjyqësor të emëruar si përkohësisht ashtu dhe në mënyrë të përhershme i nënshtrohet kushteve të sigurisë dhe monitorimit të vazhdueshëm sipas neneve 48, 49, 50, 51 dhe 54 të Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i ndryshuar. Pra, nëpërmjet emërimit të përkohshëm garantohet si parimi i vazhdimësisë institucionale dhe funksionalitetit ashtu dhe monitorimi i vazhdueshëm i nëpunësit civil gjyqësor nga ILDKPKI, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Oficeri përgjegjës në Byronë Kombëtare të Hetimit për shqyrtimin çdo muaj të komunikimeve telefonike, mesazheve apo postës elektronike.

22. Sa më sipër u arsyetua, Këshilli i Gjykatës çmon se, z. Grilest Marku, duhet të caktohet në mënyrë të përkohshme, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit civil gjyqësor” në pozicionin e punës “Specialist i Shërbimeve Gjyqësore”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri në përfundimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës sipas Ligjit Nr. 95/2016.

2. Lidhur me fillimin e prodhimit të efekteve financiare.

23. Në Ligjin Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është rregulluar statusi i punonjësve të administratës gjyqësore në detyrë. Kështu, në nenin 87 të këtij Ligji nën titullin “**Vazhdimi ose përfundimi i kontratës së punës**”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rast se nuk bëhet ankim brenda afatit të parashikuar, **vendimi i Këshillit të Gjykatës për statusin e punonjësit në detyrë në gjykatë bëhet përfundimtar dhe kontrata e punësimit e punonjësit në detyrë, statusi i të cilit konsiderohet ai i nëpunësit civil gjyqësor, përfundon efektet në datën e fundit të afatit të ankimit.** Punonjësit e tjerë në gjykatë vazhdojnë të konsiderohen si të punësuar në përputhje me kontratën e punësimit, bazuar në Kodin e Punës. 2. Në rast se bëhet ankim, vendimi për statusin e nëpunësit në detyrë të gjykatës bëhet përfundimtar me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në rast të njohjes së statusit të nëpunësit civil gjyqësor nga gjykata, kontrata e punësimit të nëpunësit përkatës në detyrë përfundon në ditën e njoftimit të vendimit gjyqësor përfundimtar. 3. Punonjësit në detyrë, periudha e provës së të cilëve nuk ka përfunduar në datën kur bëhet përfundimtar vendimi për statusin e tyre, i nënshtrohen periudhës së provës, sipas kontratës së tyre të punësimit. Dispozitat e këtij ligji për vlerësimin e punës dhe për vendimin në fund të periudhës së provës zbatohen për çdo nëpunës civil gjyqësor në provë.”. Nga interpretimi logjik dhe sistematik i këtyre dispozitave lidhur me të punësuarit në detyrë në Gjykatë e arrihet në këto përfundime: **i)** marrëdhënia e tyre është rregulluar me Kodin e Punës para hyrjes në fuqi të këtij ligji; **ii)** Këshillat e gjykatave për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar konfirmojnë të punësuarit në detyrë nëpërmjet një vendimi të shkruar, sipas parashikimeve të nenit 85, të këtij ligji, nëse i punësuarit në detyrë në gjykatë, si dhe familjarët e afërm të tij, japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, brenda dy javëve nga krijimi i gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar; **iii)** Konfirmohen në detyrë vetëm punonjësit që plotësojnë kriteret formale sipas nenit 56 të këtij ligji; **iv)** vendimi i Këshillit të Gjykatës për statusin e punonjësit në detyrë në gjykatë bëhet përfundimtar dhe kontrata e punësimit e punonjësit në detyrë, statusi i të cilit konsiderohet ai

i nëpunësit civil gjyqësor, përfundon efektet në datën e fundit të afatit të ankimit që është brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit.

23.1. Mbështetur në këtë dispozitë, punonjësit në detyrë në gjykatë, që plotësojnë kushtet për të fituar statusin e “Nëpunësit civil gjyqësor” kanë të drejtë të kundërshtojnë në gjykatë vendimin e Këshillit të Gjykatës brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit. **Vendimi i Këshillit të Gjykatës për statusin e punonjësit në detyrë në gjykatë hynë në fuqi dhe kontrata e punësimit e punonjësit në detyrë, statusi i të cilit konsiderohet ai i nëpunësit civil gjyqësor, përfundon efektet në datën e fundit të afatit të ankimit.** Ndodhur në këto kushte, për z. Griselt Marku kontrata e punës përfundon efektet në datën e fundit të afatit të ankimit. Pas përfundimit të afatit të ankimit në gjykatë, z. Griselt Marku do t’i fillojnë efektet financiare si “Nëpunës civil gjyqësor”, kategoria e pagës IV-1, sipas lidhjes 6/1 të VKM-së Nr. 325, datë 31.5.2023, si dhe bazuar në nenin 44/1 pika 1 të Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i ndryshuar, nën titullin “Shpërblimi për vështirësi pune”, ku parashikohet shprehimisht se: “1. Nëpunësi civil gjyqësor në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar përfiton shtesë për vështirësi pune në masën 50 për qind të pagës përkatëse.”, do të përfitoj shtesë për vështirësi pune në masën 50 për qind të pagës. Pra, në rastin konkret Këshilli i Gjykatës duhet të presë afatin e ankimit vetëm për sa i përket efekteve financiare, ndërsa për sa i përket përmbushjes së detyrave funksionale në vendin e punës ku punonjësit janë caktuar përkohësisht, efektet e këtij vendimit janë të menjëhershme.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Gjykatës, bazuar në nenet 4, 7, 15 pika 2, 18, 41, 42, 59, 81, pika 2, shkronja “a”, 107, 122, 135 pika 2 dhe 4, 138, 144 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenin 20 të Konventës Penale për Korrupsionin, ratifikuar me Ligjin Nr. 8778, datë 26.04.2001; nenin 36 të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, ratifikuar me Ligjin Nr. 9492, datë 13.03.2006; nenin 9 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj, ratifikuar me Ligjin Nr. Nr. 8920, datë 11.7.2002; nenet 4 dhe 115 të Kodit të Punës; nenet 4, 13, 14 dhe 16 të K. Pr. Administrative; nenet 1 germa “c”, “ç”, dhe “d”, 2 pika “ë”, “gj” dhe “j”, 8, 9, 11, 26 pika 2, 27, 28, 37 germa “e” dhe “g”, 38 germa “a”, “b”, “c” dhe “ç”, 39 germa “a” dhe “b”, 41, 49, 50, 51, 55, 56, 60 pika 1, 62 pika 5, 64, 85, 86, 87 dhe 91 pika 4 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 44 pika 1, 44/1 pika 1, 46 dhe 48 të Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i ndryshuar; nenin 162 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 3, 4, 5, 6, 7, 8 pika 2, germa “a” dhe 9, germa “a” të Ligjit Nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”; nenit 2 pika 4 i Ligjit Nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të krijuara me ligj”, i ndryshuar; Ligji Nr. 10160, datë 15.10.2009

“Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publikë dhe Nëpunësit Civilë”, i ndryshuar; vendimi Nr. 597, datë 13.10.2021, “Për përcaktimin e Personaliteteve dhe objekteve të tjera, që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë” i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar; Vendimi Nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar; Vendimi Nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike”, i Këshillit të Ministrave; Urdhri Nr. 1830 datë 3.4.2001 i Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore”; vendimin Nr. 286, datë 18.12.2019 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” të Këshillit të Lartë Gjyqësor; nenet 4, 5, 6 dhe 7 të vendimi Nr. 338, datë 24.9.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, i Këshillit të Lartë Gjyqësor; Vendimin Nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Vendimin Nr. 556, datë 29.12.2022 “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Vendimin Nr. 147, datë 29.03.2023 “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Vendimin Nr. 148, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e Parë, me Zyrë Shërbimi”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Vendimin Nr. 150, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e dytë dhe e tretë me Zyra Shërbimi”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; nenin 9 të vendimit Nr. 298, datë 30.05.2023 “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës të Parë Tiranë”, të Këshilli i Lartë Gjyqësor; Vendimin Nr. 44, datë 24.07.2023 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për administratën gjyqësore”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Vendimet Nr. 14, datë 22.05.2006; Nr. 20, datë 11.07.2006; Nr. 9, datë 26.02.2007; Nr. 19, datë 03.05.2007; Nr. 36, datë 15.10.2007; Nr.11, datë 02.04.2008; Nr. 24, datë 12.11.2008; Nr. 25, datë 05.12.2008; Nr. 28, datë 16.12.2008; Nr. 31, datë 2.12.2009; Nr. 9, datë 23.03.2010; Nr. 4 datë 12.02.2010; Nr. 11, datë 06.04.2010; Nr. 29, datë 31.05.2010; Nr. 20, datë 01.06.2011; Nr. 52, datë 01.12.2011; Nr. 48 datë 15.11.2013; Nr. 10 datë 06.03.2014; Nr. 16, datë 10.04.2015; Nr. 46, datë 29.06.2015; Nr. 4, datë 23.02.2016; Nr. 55, datë 27.07.2016; Nr. 60, datë 16.09.2016 dhe Nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese; Vendimin Nr. 7, datë 01.06.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, miratuar me vendimin Nr. 22, datë 29.12.2022 të Këshillit të Gjykatës, në vendimin Nr.

6, datë 07.07.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” të Këshillit të Gjykatës, si dhe në me vendimin Nr. 7, datë 13.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin Nr. 6, datë 07.07.2023, “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe për miratimin e përshkrimeve të detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të Këshillit të Gjykatës,

V E N D O S I:

- 1. Z. Griselt Marku**, caktohet përkohësisht, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit civil gjyqësor” në pozicionin e punës “Specialist i Shërbimeve Gjyqësore”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri në përfundimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës sipas Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i ndryshuar.
- 2.** Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kancelari, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve.
- 3.** Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda tri javëve.
- 4.** Fillimi i prodhimit të efekteve financiare për efekt të këtij vendimi do të fillojnë me lëshimin e urdhrin nga titullari i institucionit për Drejtorin e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.
- 5.** Për disponimet e tjera ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 6.** Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda dy javëve duke filluar ky afat nga nesërmja e komunikimit të këtij vendimi z. Griselt Marku.

KËSHILLI I GJYKATËS

Anëtar/Kancelar

Kryetar/Zëvendëskryetar

Anëtar/Gjyqtar

Saimir SHYTI

Erjon BANI

Erjon ÇELA